

**BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE**

**VOLUMI 18**

**(KORRIK-DHJETOR 2025)**

## **PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE**

1.Vendim nr. ____ datë 24.06.2025.....	4
2.Vendim nr. ____ datë 28.01.2025 .....	8
3.Vendim nr. ____, datë 01.10.2025 .....	11
4.Vendim nr. ____, datë 13.11.2025.....	12
5.Vendim nr. ____, datë 18.06.2025.....	14
6.Vendim nr. ____ datë 20.11.2025.....	15
7.Vendim nr. ____, datë 05.03.2025.....	18
8.Vendim nr. ____, datë 05.03.2025.....	21
9.Vendim nr. ____, datë 22.05.2024.....	23
10.Vendim nr. ____, datë 20.11.2025.....	25
11.Vendim nr. ____, datë 15.07.2024 .....	27
12.Vendim nr. ____, datë 15.07.2024.....	30
13.Vendim nr. ____, datë 21.05.2025.....	32
14.Vendim nr. ____, datë 15.05.2025 .....	33
15.Vendim nr. ____, datë 12.03.2025 .....	34
16.Vendim nr. ____, datë 13.11.2025 .....	36
17.Vendim nr. ____, datë 23.10.2025 .....	38
18.Vendim nr. ____, datë 18.06.2025 .....	41
19.Vendim nr. ____, datë 15.10.2025 .....	48

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjatë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c/6/legjislacioni>

### ***Shënim!***

*Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.*

1. **Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 24.06.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** J.T- Person Fizik, me NIPT L \_\_\_\_\_, me adresë në Lagjja “Mustafa Matohiti”, Tepelenë.

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë.

*Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit.*

**Objekti:** Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, Raport përfundimtar i kontrollit tatimor nr.\_\_\_\_ Prot., datë 03.08.2015. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr.\_\_\_\_., datë 05.10.2015.

**Shuma e detyrimit tatimor:** Detyrimet nga raporti i kontrollit, në shumën totale \_\_\_\_\_ lekë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 7/a, 14, 15/a, 16/2/b, 17/c të tij; Kodi i Procedurave Administrative, nenet 108, 109, 110, 111 të tij.

**Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Gjatë vitit 2015, paditësi ka qenë subjekt i kontrollit të thelluar nga organi tatimor, kontroll ky i njoftuar nëpërmjet Njoftim Kontrollit Tatimor nr.\_\_\_\_ prot., datë 03.08.2015, për të cilin paditësi ka marrë dijeni nëpërmjet shërbimit postar. Më vonë i është dërguar Programi i Kontrollit, në bazë të të cilit specifikoheshin llojet e tatimit dhe periodha përkatëse për të cilën do të ushtrohej kontroll.

Në vijim të procedurës paditësi ka marrë dijeni rregullisht për Projekt Raport Kontrolli Tatimor nr.\_\_\_\_ prot., datë 31.08.2015 dhe pasi është njohur me rezultatet e kontrollit, shumën e detyrimeve të propozuara dhe referencat ligjore, që justifikojnë propozimin e bërë, nuk ka depozituar asnjë kundërshtim për detyrimet e pasqyruara në këtë akt. Në mbyllje të procedurës së kontrollit në zbatim të nenit 84, pika 3, të ligjit nr.9920/2008, bashkëngjitur Raport Kontrollit Tatimor Përfundimtar nr.\_\_\_\_ prot., datë 06.10.2015, është kryer procedura për pasqyrimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr.\_\_\_\_ prot. datë 05.10.2015, në sistemin informatik tatimor C@TS, duke ia komunikuar këto akte nëpërmjet shërbimit postar.

Duke qenë se paditësi, nuk ka qenë dakord me detyrimet që i kanë lindur ndaj organit tatimor, ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tyre në gjykatë nëpërmjet kërkesëpadisë me palët dhe objektin e sipërcituar, pa u drejtuar paraprakisht pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

## **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit vëren se, në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, sikurse ka vlerësuar drejt edhe gjykata administrative e shkallës së parë, ankimi i palës paditëse është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr.49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, brenda afatit ligjor, në respektim të formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 454 i Kodit të Procedurës Civile, para gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar aktivisht në padi, legjitimuar në të drejtën e ankimit, jashtë kushteve ndaluese të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 (vendimet e paankimueshme).

Duke e gjetur të pranueshëm ligjërisht ankimin e ushtruar prej kësaj pale sipas dispozitave procedurale të sipërcituara, Gjykata Administrative e Apelit verifikoi respektimin e standardeve të një procesi të rregullt gjyqësor të zhvilluar nga gjykata administrative e shkallës së parë, ku nuk u konstatuan shkelje procedurale në këndvështrim të nenit 50, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, për të cilat ligji parashikon pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimin.

Në analizë të shkaqeve të ngritura në ankimin e palës paditëse, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër objekt ankimi nr. \_\_\_\_\_, datë 06.06.2018, që ka ardhur në përfundimin e rrëzimit të padisë, duhet të lihet në fuqi.

Në shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimtarisë administrative të palëve të paditura në raport me pretendimet e ngritura në ankim, Gjykata Administrative e Apelit i referohet parimit procedural të gjykimin administrativ të sanksionuar në neni 37, pika 1 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, parim sipas të cilit gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.

Në trajtimin doktrinar, një akt administrativ është i ligjshëm, nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat që parashikohen në Kodin e Procedurave Administrative si dhe në legjislacionin në fuqi. Ky është kuptimi që jep neni 107 për ligjshmërinë e aktit administrativ. Mosrespektimi i këtyre kushteve passjell pavlefshmërinë e aktit, e cila vlerësohet në varësi të mangësisë së përmbajtjes së tij, të kompetencës së organit publik, ose të shkallës së shkeljes të procedurës dhe formës së kërkuar nga ligji. Për shkak të shkeljes thelbësore të ligjit, një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk e ka fuqinë juridike të një akti të vlefshëm dhe objektivist konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar për asnjë çast. Një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, nuk është akt. Pavlefshmëria absolute e aktit është një gjendje e tillë, ku ka mungesë të plotë të efekteve juridike nga akti. Akti që në momentin e nxjerrjes së tij nuk krijon dhe as nuk mund të krijojë pasojat juridike, për të cilat është nxjerrë. Ai është një nulitet i plotë, një akt i dështuar, i cili nuk ka hyrë kurrë në fuqi. Një akt i tillë nuk ka fuqi detyruese ndaj personave a subjekteve të

cilëve u drejtohet dhe, si rrjedhojë, këta ose çdo organ tjetër mund të kundërshtojnë drejtpërdrejt plotësimin e detyrimeve a urdhërimeve që rrjedhin prej tij ose mund ta mënjanojnë atë, pa qenë nevoja që për pavlefshmërinë të shprehet domosdoshmërisht ndonjë organ. Në qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr.3, datë 12.02.2008, vërehet se: "...Gjykata e nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor vetëm kur paditësi, për faj të tij, nuk e ka paraqitur ankimin administrativ në afat ose nuk ka kompletuar dokumentet shoqëruese sipas ligjit (megjithëse organi administrativ e ka vënë në dijeni për të metat e ankimimit... Po kështu, nëse pretendohet pavlefshmëria absolute e akteve, kërkim që nuk është i ndërvaruar nga ndonjë afat parashkrimi, gjykata, nuk mund të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, por në zbatim të nenit 121 të K.Pr.Administrative dhe 331 të K.Pr.Civile, konstaton pavlefshmërinë për efekt të zgjidhjes së pasojave juridike që janë krijuar nga akti..."

Mbi bazën e kërkimeve të materializuara në objektin e padisë, pretendimeve të ngritura gjatë gjykimit në shkallë të parë si dhe ato të parashtruara në ankim, rezulton se pala paditëse e ka orientuar shqyrtimin gjyqësor në analizën e ekzistencës ose jo të shkaqeve të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ objekt gjykimi: Njoftim vlerësimit për detyrimet nr.\_\_\_\_ prot., datë 05.10.2015, në kuptim të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative, që parashikon se:

*Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:*

*a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:*

*i) kompetencën e organit publik;*

*ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose*

*iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;*

*b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale;*

*c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;*

*ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.*

Në nxjerrjen e aktit administrativ objekt gjykimi: Njoftim Vlerësimit për Detyrimet nr.\_\_\_\_, datë 05.10.2015, nuk konkurren asnjë nga kushtet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, pasi ky është nxjerrë nga organi i identifikuar dhe brenda kompetencës së tij, në respektim të formës dhe procedurës së nxjerrjes së aktit sipas ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij (udhëzim i Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar). Gjykata e shkallës së parë ka interpretuar drejt ligjin, duke analizuar se akti-Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr.\_\_\_\_ prot., datë 05.10.2015, është nxjerrë nga një organ i identifikuar, pikërisht nga DRT Gjirokastrë, ka firmën e titullarit të institucionit si dhe mban vulën e institucionit, duke respektuar procedurën e parashikuar nga ligji. Referuar përmbajtjes së nenit 84 e 85 të ligjit nr. 9920/2008 i ndryshuar dhe aktin nënligjor të dalë në zbatim të tij konkretisht Udhëzim nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar pikës 23.3.1 të tij, ka rezultuar se pala e paditur pas përfundimit të afateve ligjore të mësipërme të njoftimit të projekt raport kontrollit tatimor me datë 20.09.2017, në zbatim të dispozitës ligjore të mësipërme neni 84

ka nxjerrë raport kontrollin tatimor përfundimtar, i cili i është njoftuar subjektit paditës nëpërmjet shkresës nr.\_\_\_\_ prot., datë 06.10.2015.

Mbi bazën e raport kontrollit tatimor përfundimtar të mësipërm, pala e paditur ka nxjerrë Njoftim Vlerësimin për detyrimet nr.\_\_\_\_ prot., datë 05.10.2015, objekt shqyrtimi. Pretendimi i palës paditëse se akti objekt gjykimi është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm sepse në periudhën e ushtrimit të kontrollit tatimor dhe të njoftimit të akteve të kontrollit tatimor nuk ndodhej në Shqipëri dhe për këtë fakt ai nuk ka pasur dijeni, nuk çon në pavlefshmëri absolute të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore objekt shqyrtimi gjyqësor. Gjykata, me të drejtë çmon se bazuar në paragrafin 5, të faqes 3, të vendimit nr.\_\_\_\_, datë 24.11.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, të paraqitur në seancë gjyqësore si provë nga vetë paditësi, në të cilën thuhet: “detyrimet e përshkruara në këtë raport kontrolli tatimor, i janë njoftuar subjektit më anë të dokumentit të datës 05.10.2015 “Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore”, hedh poshtë pretendimin e palës paditëse se nuk është njohur me aktin administrativ njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore. Gjykata Administrative e Apelit i referohet përmbajtjes së vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 24.11.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, ku citohet se:

*“...Në ndryshim nga sa arsyetohet në vendimin objekt ankimi, Gjykata e Apelit çmon se mbi bazën e provave të marra gjatë këtij gjykimi, nuk rezulton e provuar që i pandehuri J.T të ketë kryer punime ndërtimi, për të cilat kishte detyrimin ligjor për të deklaruar në organet tatimore, pas datës 04.06.2013, kur rezulton të ketë hyrë në fuqi ligji nr.144/2013, që ka ndryshuar nenin 180 të KP...*

*... Nga zbatimi i nenit 4 të KPP, i ndryshuar me anën e ligjit nr.35/2017 në raport me gjendjen e provave të paraqitura nga organi i akuzës dhe të analizuara si më sipër, Gjykata e Apelit çmon se nuk vërtetohet fajësia e të pandehurit Jorgo Tola për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 180 i KP dhe se të gjitha dyshimet e trajtuara më lart në lidhje me këtë akuzë të ngritur, duhet të çmohen në favor të pandehurit. Mungesa e provave në drejtim të fajësisë të pandehurit, në kuptim të nenit 388/d të KPP, passjell disponimin për dhënien e vendimit të pafajësisë”...*

Dukshëm, nga përmbajtja e këtij vendimi gjyqësor penal të formës së prerë, gjykata penale ka ardhur në përfundimin se nuk vërtetohet fajësia e të pandehurit J.T për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave” me arsyetimin se dyshimet për akuzën, duhet të çmohen në favor të të pandehurit. Në këtë vendim gjyqësor penal, në të kundërt sa pretendon pala paditëse në ankim, nuk rezulton të jetë konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit administrativ objekt gjykimi: Njoftim vlerësimi për detyrimet nr.\_\_\_\_ prot., datë 05.10.2015, që është kompetencë ekskluzive e gjykatës administrative sipas parashikimeve të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar. Nëse pala e paditur në nxjerrjen e këtij akti ka vepruar ose jo në kundërshtim me ligjin kjo është një çështje që lidhet me pavlefshmërinë relative (paligjshmërinë e aktit), të cilën gjykata nuk e ka objekt të shqyrtimit gjyqësor, në bazë të parimit procedural të sanksionuar në nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile. Ndërsa, Gjykata e Apelit thekson se raport kontrolli tatimor përfundimtar nr.\_\_\_\_ prot., datë 06.10.2015, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër që kundërshtohet nga paditësi në objektin e padisë, nuk përbën akt administrativ në kuptim të nenit 2 të ligjit nr.49/2012, pasi akt administrativ individual është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj

një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Raport kontrolli përbën një akt paraprak, që i ka paraprirë nxjerrjes së Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore nr. \_\_\_\_ prot., datë 05.10.2015, dhe si i tillë nuk krijon marrëdhënie juridike të detyrimit ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore dhe për rrjedhojë nuk mund të goditet gjyqësisht me padi.

Të gjitha shkaqet e ngritura në ankimin e palës paditëse janë parashtruar edhe në formë pretendimesh giatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, të cilave u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e kësaj gjykate, përmes një analize të hollësishme ligjore në kompleksitet me faktet dhe provat që i janë nënshtruar debatit gjyqësor, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 42 të Kushtetutës, parim i konkretizuar edhe në nenin 3 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar: “Gjykata, në gjykimin administrativ, siguron nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të çënohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike”.

Për sa më lartë arsyetuar, Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50, shkronja “b” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar arrin në përfundimin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet lënë në fuqi si i bazuar në ligj.

### **Vendimi i gjykatës:**

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.\_\_\_\_, datë 06.06.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.*

### **2. Vendim Nr. \_\_\_\_\_ Date 28.01.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** Shoqëria “P” shpk me NIPT L\_\_\_\_\_

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë  
Drejtoria e Apelimit Tatimor

**Objekti:** 1. Shfuqizimin e pjesshëm të Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore nr.

\_\_\_\_ prot., datë 06.06.2016 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë  
2. Shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr. \_\_\_\_\_ prot., datë 27.09.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor

**Shuma e detyrimit tatimor:** \_\_\_\_\_ lekë

**Baza Ligjore :**

1. Nenet 7,11/1,15/a, 17/a e vijues të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
2. Neni 69 e vijues i ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”;
3. VKM nr. 418, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”;
4. Ligji nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
5. Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

**Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Shoqëria “P” shpk është subjekt juridik i së drejtës tregtare e organizuar ne formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Tiranë e regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe në QKR në datë 24.10.2016 me NIPT L\_\_\_\_\_. Objekti i veprimtarisë së saj tregtare është i ndryshëm, por kryesisht në fushën e menaxhimit dhe mbledhjes së kredive etj.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. \_\_\_\_ prot., datë 16.03.2016 ka njoftuar shoqërinë “P” shpk, me njoftim kontrolli të vetëdeklarimeve dhe llogaritjes së derdhjes së detyrimeve nga tatimpaguesi. Zbatimi i kërkesave të legjislacionit fiskal. Periudha e përcaktuar për kontroll ka qenë për:

Tatimi mbi vlerën e shtuar për periudhën 02/2013-12/2015, Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore dhe Tatimin mbi të Ardhurat Personale për periudhën 02/2013-12/2015.

Në përfundim të kontrollit nga ana e inspektorëve tatimorë më datë 06.06.2016 është përgatitur raporti i kontrollit përfundimtar. Bazuar në përfundimet e raportit të kontrollit përfundimtar datë 06.06.2016 nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë është nxjerrë Njoftim Vlerësimi nr. \_\_\_\_ prot., datë 06.06.2016 për detyrimet në vlerën \_\_\_\_\_ lekë. Më ardhjen në dijeni të këtij akti, pala paditëse i është drejtuar Drejtorisë së Apelimit Tatimor, e cila me vendimin nr. \_\_\_\_\_ prot., datë 27.09.2016 ka vendosur lënien në fuqi të Njoftim Vlerësimit në shumën \_\_\_\_\_ dhe shfuqizimin e tij në vlerën \_\_\_\_ lekë. Pas marrjes dijeni të këtij vendimi, pala paditëse i është drejtuar gjykatës.

**Vlerësimi i Gjykatës:** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë

20.04.2017 ka vendosur:

- Pranimin e kërkesëpadisë së shoqërisë “P”shpk.
- Shfuqizimin e pjesshëm të aktit njoftim vlerësimi tatimor nr. \_\_\_\_ Prot., datë 06.06.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, si dhe shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë nr. \_\_\_\_ Prot., datë 27.09.2016.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe Avokatura e Shtetit kanë ankimuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vlerëson se pretendimet e paraqitura prej palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit qëndrojnë dhe për pasojë vendimi të ndryshohet.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga raporti i kontrollit dhe akt-ekspertimi i vlerësuar nga Gjykata, rezultojnë se punimet e kryera nga shoqëria paditëse nuk kanë qenë thjesht furnizime mallrash, por punime montimi elektrik, sisteme sigurie, ndriçimi dhe ndërhyrje infrastrukturore, të cilat ligji i konsideron të detyrueshme për t’u shoqëruar me deklaratë paraprake. Instalimi i sistemeve elektrike dhe i rrjeteve të integruara përbën punim ndërtimor në kuptim të nenit 39 të ligjit nr. 107/2014, i cili kërkon deklaratë paraprake. Në mungesë të lejes këto punime nuk përjashtohen nga detyrimi për TVSH-në dhe nuk njihen për efekt kreditimi.

Lidhur me pretendimin e parashtruar nga pala paditëse dhe të pranuar edhe nga gjykata e shkallës së parë se punimet e kryera nuk kërkonin leje, duke i konsideruar “punime të brendshme”, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ky interpretim bie në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 dhe VKM-në nr. 408/2015, që i klasifikojnë këto punime si të detyruara me deklaratë paraprake. Gjykata e Shkallës së Parë ka bërë një interpretim të gabuar duke u bazuar në kontrata të lidhura dhe fatura të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 408/2015, por edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 107/2014 deklarata ishte kusht i domosdoshëm për ndërhyrjet ndërtimore dhe montimet e këtij karakteri.

Në rastin konkret, edhe pse kontrata dhe faturat janë lëshuar para datës 21.05.2015, **efektet e tyre juridike fiskale dhe territoriale shtrihen edhe pas kësaj date**. Kjo do të thotë se ato i nënshtrohen regjimit juridik në fuqi në momentin e realizimit ose kontrollit të pasojave të tyre, pra pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 408/2015. Në këtë kuptim zbatimi i kontratës dhe efekteve të saj është subjekt i ligjit të ri, pasi pasojat e saj shtrihen në kohë dhe nuk janë shteruar para hyrjes në fuqi të VKM-së. Ajo që ka rëndësi nuk është vetëm data e nënshkrimit apo lëshimit të faturës, por periudha e zbatimit, ekzekutimit dhe kontrollit të efekteve të tyre, të cilat zhvillohen pas datës 21.05.2015 dhe për rrjedhojë rregullohen nga VKM nr. 408/2015.

Lidhur me pretendimin se VKM nr. 408/2015 nuk ka fuqi prapavepruese pasi disa fatura janë të periudhës janar 2015, nuk qëndron, pasi ligji nr. 107/2014 ishte tashmë në fuqi dhe kërkonte që çdo punim që prek strukturën ose sistemet teknike të ndërtesës të ishte i pajisur me leje. Pra, edhe përpara hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 408/2015, ekzistonte detyrimi ligjor pasi kjo VKM nuk solli një detyrim

të ri, por vetëm qartësoi dhe zbatoi dispozitat e ligjit. Në çdo rast punimet ishin të ndaluara pa leje që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 107/2014.

### **Vendimi i Gjykatës:**

- *Ndryshimin e vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 20.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*
- *Rrëzimin e kërkesëpadisë.*

### **3. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 01.10.25, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria “A” me Nipt L \_\_\_\_\_

**Të Paditur:** Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë  
Drejtoria e Apelimit Tatimor

**Objekti:** Shfuqizim i pjeshëm i aktit administrativ nr. \_\_\_\_\_, datë 31.07.2017 i DTM-së; Shfuqizim i pjeshëm i vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 30.11.2017, i DAT.

**Shuma e detyrimit tatimor:** \_\_\_\_\_ lekë

### **Baza Ligjore:**

- Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative; - Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse si dhe udhëzimi në fuqi në zbatim të tij; - Ligji nr. 7928, date 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” me ndryshimet përkatëse si dhe udhëzimi në fuqi në zbatim të tij; - Ligji nr.92/2014 datë 27.04.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, me ndryshimet përkatëse si dhe udhëzimi në fuqi në zbatim të tij; - Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi te ardhurat”, me ndryshimet përkatëse si dhe udhëzimi në zbatim të tij; - Ligji Nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme te sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; - Ligji Nr.9975 datë 27.08.2008 “Për taksat kombëtare”; - Ligji Nr.8977 datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

### **Permbledhje e rrethanave të faktit:**

Tatimpaguesi është kontrolluar në zbatim të Njoftimit për Kontroll nr. \_\_\_\_\_ prot, datë 12.10.2016

dhe programit të kontrollit bashkëlidhur tij. Periudhat tatimore dhe llojet e tatimeve që janë kontrolluar, sipas programit të kontrollit janë:

- a) Për TVSH ..... Korrik 2015 – korrik 2016;
- b) Për Tatim fitimin ..... Viti 2015
- c) Për Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Korrik 2015 – korrik 2016

Në përfundim të kontrollit është hartuar raporti, ku janë përshkruar shkeljet e konstatuara dhe janë kryer vlerësimet përkatëse.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.\_\_\_\_, datë 11.06.2018, ka vendosur: ***Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.***

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 01.10.2025 ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr.\_\_\_\_, datë 11.06.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Të dyja gjykatat në arsyetimin e tyre kanë pranuar se DTM ka trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në ligj mospërputhjet ndërmjet rregjistrimeve fiskale dhe deklarimeve në FDP, duke mbështetur konkluzionin se mosdeklarimi i kësaj vlere përbën shitje të padeklaruar, e ndëshkueshme me gjobë në masën 100% të detyrimit tatimor, sipas nenit 124 të ligjit nr.9920/2008. Gjykatat vlerësojnë se metoda e analizës së përdorur nga DTM konsiderohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin tatimor për shitjet e kryera nëpërmjet sistemeve fiskale dhe deklarimet e furnizimeve të kryera në deklaratat mujore si dhe matematikisht e saktë.

### **Vendimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 01.10.2025 ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 11.06.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.*

### **4. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 13.11.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** Shoqëria “E”

**Të paditur:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj;  
Drejtoria e Apelimit Tatimor

**Objekti:** Konstatim pavlefshmërie Njoftim Vlerësimi nr.\_\_\_\_\_, datë 23.03.2017

**Shuma e detyrimit tatimor:** \_\_\_\_\_

**Baza Ligjore:** Ligj nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Ligj nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar etj

**Permbledhje e rrethanave të faktit:**

Sipas njoftim kontrollit, grupi i kontrollit u paraqit më datë 19.01.2017 në selinë e shoqërisë. Komunikimi me administratorin apo ndonjë përfaqësues të shoqërisë ishte i pamundur pasi lidhja nëpërmjet numrit të telefonit të deklaruar në QKR nga ana e subjektit/ tatimpaguesit nuk u arrit të realizohej. Mosvënia në dispozicion e dokumentacionit për periudhën objekt kontrolli, apo mospërcaktimi i ndonjë afati për vënien në dispozicion të këtij dokumentacioni nga ana e subjektit, ka pamundësuar kryerjen e kontrollit tatimor.

Bazuar në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, pika 1 dhe neni 72, pika 1, nga grupi i kontrollit propozohet të bëhet vlerësimi tatimor duke u bazuar në deklaratat tatimore të dorëzuara në sistemin informatik të tatimeve, propozim i cili është gjetur i bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi dhe është mbështetur nga ana e Drejtorit të Dejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.

**Vlerësimi i Gjykatës:**

Administrata Tatimore ka vepruar në zbatim të legjislacionit në fuqi në nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit objekt padie dhe konkretisht në mbështetje të neneve 71, 72, 80 dhe 81 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në kushtet ku Administrata Tatimore është përpjekur disa herë për të kontaktuar me përfaqësuesit/ administratorin e shoqërisë, por pa rezultat, ka kryer rivlerësim tatimor nga zyra referuar vetë deklarimeve të shoqërisë. Njoftim vlerësimi është nxjerrë në zbatim të plotë të procedurës së parashikuar në ligjin nr.9920/2008, i ndryshuar dhe bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, nuk jemi përpara ndonjërit nga rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi, lidhur me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ.

**Vendimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin nr.\_\_\_\_, datë 30.10.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila ka vendosur:

- *Rrëzimin e padisë së shoqërisë “E”...*

**5. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 18.06.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** “P.C” sha, me seli në Tiranë

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj

**Objekti:** Shfuqizimi i njoftim vlerësimit tatimor nr.\_\_\_\_, datë 31.08.2018; Shfuqizimin e vendimit nr.\_\_\_\_, datë 17.12.2018, të Komisionit të Apelimit Tatimor.

**Shuma e detyrimit tatimor:** \_\_\_\_\_ lekë.

**Baza Ligjore:**

- Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, neni 21; - Udhëzimi nr.5, datë 30.01.2006; - Ligji nr.7928 datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, i ndryshuar, neni 33 pika 4 dhe Udhëzimi nr. 17 datë 13.05.2008; - Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; - Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.

**Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Nga kontrolli për vitin 2017, ka rezultuar se rubrika rregullim i tvsh-së në blerje në shumën \_\_\_\_\_ lekë dhe tvsh në shumën \_\_\_\_\_ lekë ka të bëjë me rregullimin e tvsh-së për mallrat e dalë jashtë përdorimit.

Shoqëria me shkresën nr.\_\_\_\_ Prot, datë 31.01.2018, protokolluar në DTM me nr.\_\_\_\_ Prot. datë 31.01.2018, ka njoftuar për nxjerrje jashtë përdorimi të mallrave kapitale të patrupëzuara (licence, software dhe makineri e pajisje që lidhen me to, të cilat shërbenin dhe mundësonin ofrimin e shërbimit të telekomunikacionit). Vlera e blerjes pa tvsh është \_\_\_\_\_ lekë, vlera e amortizimit sipas Standardeve (SNRF) është \_\_\_\_\_ lekë dhe vlera e mbetur në shumën \_\_\_\_\_ lekë, vlera e amortizimit për efekte fiskale është \_\_\_\_\_ lekë dhe vlera e mbetur është \_\_\_\_\_ lekë.

Vlera e mbetur e AAM në shumën \_\_\_\_\_ lekë, nuk njihet si shpenzim i zbritshëm për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm bazuar kjo në parashikimet e ligjit nr. 8438/1998, neni 20, paragrafi i dytë dhe neni 22.

**Vlerësimi i Gjykatës:**

Shoqëria ka vepruar në bazë të Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 82, Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015; si dhe ligjit Nr. 8438, Datë 28.12.1998 dhe Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Ndërkohë, ligji për mallrat kapitale nuk ka të përcaktuar detyrimin për njoftim të organeve tatimore për nxjerrje jashtë përdorimi.

Duke qenë se në ligj nuk ka të specifikuar procedurë për nxjerrje jashtë përdorimi për mallrat kapitale, bazuar në nenin 57 “Rregullimet e zbritjes së TVSH-së” të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pala paditëse ka rregulluar

TVSH përkatëse të aseteve (mallrave kapitale) që ka nxjerrë jashtë përdorimit, sipas faturës nr.\_\_\_\_, datë 31.12.2017 me nr.serial \_\_\_\_\_. Megjithatë shoqëria njoftoi organet tatimore për nxjerrje jashtë përdorimit me shkresën nr. \_\_\_\_\_, datë 31.01.2018.

### **Vendimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me nr. \_\_\_\_\_, datë 16.04.2019:

- *Pranimin e padisë së shoqërisë “P.C” sh.a*

### **6. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 20.11.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria “AC” sh.p.k me NIPT L \_\_\_\_\_

**Të paditur:** Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë  
Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë  
Drejtoria Rajonale Tatimore Fier

**Objekti:** Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, Njoftimit të Vlerësimit Tatimor nr.\_\_\_\_ Prot., datë 25.06.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, Vendimit nr.\_\_\_\_, datë 28.08.2018 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë dhe Procesverbalit datë 16.05.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, si akte të disponuara në kundërshtim me ligjin

**Shuma e detyrimit tatimor:** Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.\_\_\_\_, datë 25.06.2018 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë për gjobën në zërin Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në shumën \_\_\_\_\_ lekë në total, për periudhën Qershor 2018.

**Baza Ligjore:** Ligji nr.47/2013, nenet 115, 118, 119 të Kodit të Procedurave Administrative; Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Ligji nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 151, 153 të K.Pr.Civile.

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Tatimpaguesi “AC” sh.p.k me NIPT L \_\_\_\_\_, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër me kërkesëpadinë me objekt si më sipërcituar.

Më datë 16.05.2018, inspektorët e zbatimit pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Jugor Fier, bazuar në Urdhrin e Punës nr.\_\_\_\_, datë 14.05.2018, kanë ushtruar kontroll tek subjekti “AC” sh.p.k, me NIPT L \_\_\_\_\_, me adresë \_\_\_\_\_, me veprimtari ekonomike ndërtim. Gjatë kontrollit të

ushtruar u mbajti akti i konstatimit me nr. \_\_\_\_\_, datë 16.05.2018 ku është konstatuar ndër të tjera se:

*Subjekti është i regjistruar në QKR me nr.serie SN\_\_\_\_\_.*

*Subjekti ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit.*

*Gjatë kontrollit në punë u gjet: 1. J.TH me datëlindje 06.07.1992, 2. F.P me datëlindje 10.09.1972 dhe 3. F.P me datëlindje 24.09.1997. Subjekti penalizohet për mosdeklarim të punonjësve me procesverbalin e gjobës nr. \_\_\_\_\_, datë 16.05.2018.*

Inspektorët e Sektorit të Zbatimit në DHT Rajoni Jugor Fier, për shkeljen e konstatuar, pasi kanë verifikuar në sistemin elektronik C@ts se personat që u gjetën në punë në momentin e kontrollit nuk ishin deklaruar si punonjës nga ana e tatimpaguesit, kanë mbajtur procesverbalin e gjobës nr.\_\_\_\_, datë 16.05.2018, me anë të të cilit ky subjekt u penalizua me gjobë në shumën \_\_\_\_ lekë (3\*200.000) për tre punonjës të padeklaruar, në zbatim të nenit 119 pika 1 gërma a) të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Më pas akti i konstatimit dhe procesverbalet e gjobës janë përcjellë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme ligjore.

Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë pasi është njohur me këtë akt konstatimi dhe procesverbalin e gjobës së mbajtur gjatë kontrollit të kryer tek tatimpaguesi “AC” sh.p.k dhe referuar përmbajtjes së tij, në të cilin është konstatuar se ky subjekt kishte kryer shkelje administrative ligjore pasi në momentin e kontrollit nuk kishte deklaruar në organin tatimor sipas dispozitave ligjore në fuqi punonjësit e tij z. F.P, z. J.Th dhe z.F.P, të cilët u gjetën në punë në momentin e ushtrimit të verifikimit në terren, ka vijuar me kryerjen e procedurave të mëtejshme ligjore duke nxjerrë Njoftim Vlerësimin për detyrimet tatimore nr.\_\_\_\_ Prot., datë 25.06.2018 për shoqërinë “AC” sh.p.k, me anë të të cilit është nxjerrë detyrimi gjobë në shumën \_\_\_\_ lekë, në zbatim të nenit 119 pika 1 gërma a) të Ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga ana e palës paditëse, ndaj Njoftimit të Vlerësimit Tatimor nr.\_\_\_\_, datë 25.06.2018 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, është ushtruar ankimi në DAT Tiranë, e cila nëpërmjet vendimit nr.\_\_\_\_, datë 28.08.2018 ka vendosur: *Lënien në fuqi të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.\_\_\_\_ Prot., datë 25.06.2018, nxjerrë nga DRT Sarandë, për gjobën në vlerën \_\_\_\_ lekë për mosdeklarim punonjësish.*

Më pas ky tatimpagues ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor, ndaj këtyre akteve administrative, duke iu drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër me kërkesëpadinë me objekt dhe bazë ligjore si më sipërcituar. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ka disponuar me vendimin nr.\_\_\_\_, datë 30.10.2018, duke vendosur:

*1. Pranimin e kërkesëpadisë.*

*2. Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit nr.\_\_\_\_, datë 25.06.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr.\_\_\_\_ Prot., datë 28.08.2018 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.*

*3. Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqëse.*

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të

Shkallës së Parë Gjirokastër.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Referuar shkaqeve të parashtruara në ankim nga pala e paditur, argumenteve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, ligjit të zbatueshëm për rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet dhe kërkesëpadia duhet rrëzuar, si e pabazuar në ligj dhe në prova.

Në thelb në lidhje me natyrën e mosmarrëveshjes, Gjykata Administrative e Apelit evidenton se me padinë e paraqitur për shqyrtim paditësi ka pretenduar shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore, të palës së paditur DRT Sarandë, nëpërmjet të cilit i janë njoftuar palës paditëse detyrimet për të paguar si pasojë e kundërvajtjes administrative të parashikuar nga neni 119/a të ligjit nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Rezulton e provuar se subjekti paditës në datë 14.05.2018 ka lidhur kontratë pune me shtetasit kosovarë J.Th, F.P e F.P dhe i ka depozituar në Zyrën e Punësimit, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 71 pika 7 te ligjit 108/2013 “Për të huajt”, persona që u gjetën në punë në momentin e kontrollit dhe që subjekti nuk i kishte deklaruar si punonjës së tij.

Gjykata Administrative e Apelit e gjen të gabuar konkluzionin e gjykatës administrative të shkallës së parë se në këtë mënyrë me njoftimin pranë zyrës së punësimit, për shtetasit e huaj, të punësuar pranë tij, subjekti paditës ka përmbushur detyrimin ligjor, të deklarimit të personave të punësuar.

Në zbatim të Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.23 datë 09.12.2024, i nxjerrë në zbatim të këtij ligji, është përcaktuar detyrimi ligjor i çdo tatimpaguesi për të deklaruar të punësuarit në administratën tatimore, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës. Mospërmbushja e këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative të dënueshme me gjobë ne referim të kuadrit ligjor, neni 119 të Ligjit 9920/2008, i cili parashikon se: *“Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar: a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh”*.

Provohet se nëpërmjet formularit ESIG027/a, pala paditëse me deklarimin “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarave nga puna”, ka deklaruar punonjësit pranë Zyrës së Punësimit më datë 17.05.2018.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se konkluzioni i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë se paditësi nuk e ka kryer shkeljen, është në interpretim të gabuar të ligjit dhe i pabazuar në provat dhe faktet e vërtetuara në këtë gjykim.

Ligji nr.108/2013 “Për të huajt”, nuk gjen zbatim në mosmarrëveshjen në gjykim, pasi e gjithë procedura e kontrollit të subjekteve tatimpagues rregullohet në mënyrë ezauruese në ligjin për procedurat tatimore dhe aktet nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij. Pretendimet se nga ana e

inspektorëve tatimorë duhet të ishin pyetur keta punonjës nëse kishin leje pune ose jo nuk kanë bazë ligjore, pasi nuk është në kompetencë dhe detyrë funksionale të organit tatimor verifikimi dhe kontrolli i lejeve të punësimit.

Gjykata Administrative e Apelit thekson faktin se referuar nenit 35 të ligjit 49/2012, organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, të nxjerrë me iniciativë të tij.

Gjykata çmon të theksojë se organi publik palë e paditur mundi të vërtetojë gjatë gjykimit ligjshmërinë e aktit administrativ objekt kundërshtimi, pasi provoi me prova bindëse dhe të pakundërshtueshme se subjekti paditës ka kryer shkelje të ligjit duke mosdeklaruar të punësuarit pranë tij në administratën tatimore një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, dhe me të drejtë është penalizuar me gjobë në shumën \_\_\_\_\_ lekë, për tre punonjës të padeklaruar.

Aktet administrative objekt gjykimi janë akte të ligjshëm, të nxjerrë në përputhje me dispozitat ligjore.

Në përfundim Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është rrjedhojë e analizës së gabuar të provave dhe interpretimit dhe zbatimit jo korrekt të ligjit material, për rrjedhojë shkaqet e ngritura në ankim nga pala e paditur qëndrojnë dhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër duhet të ndryshohet, duke u vendosur rrëzimi i padisë, si e pambështetur në prova dhe në ligj.

#### **Vendimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr. \_\_\_\_\_, datë 20.11.2025, vendosi:

- *Ndryshimin e vendimit nr.\_\_\_\_, datë 30.10.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.*
- *Rrëzimin e kërkesëpadisë.*
- *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.*

#### **7. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 05.03.2025, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**

**Paditës:** “G.P” shpk me Nipt K \_\_\_\_\_

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan  
Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Ministrisë së Financave

**Objekti:** 1.Konstatimin e Pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore Nr.\_\_\_\_, datë 11.07.2017 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, për detyrime në vlerën \_\_\_\_\_ lekë, si të pabazuara në ligj dhe prova.

2. Konstatimin e Pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore Nr.\_\_\_\_ Prot., datë 14.09.2017 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan për detyrime në vlerën \_\_\_\_\_ lekë, si të pabazuara në ligj dhe prova.

3. Konstatimin e Pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.\_\_\_\_ Prot., datë 06.09.2017 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

**Baza ligjore:** Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi Nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.10279 datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, Kodi i Procedurës Civile; Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” etj

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Ndaj tatimpaguesit “G.P” shpk është ushtruar kontroll nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, në zbatim të Njoftim Kontrollit Tatimor Nr.\_\_\_\_, datë 24.05.2017 dhe Programit të Kontrollit, ku janë kontrolluar periudhat tatimore për detyrimet tatimore si më poshtë:

- |                             |                   |
|-----------------------------|-------------------|
| - Tatim mbi Vlerën e Shtuar | 01/2012 – 01/2017 |
| - Kontributet dhe TAP       | 01/2012 – 01/2017 |
| - Tatim Fitimi Viti         | 2012-2015         |
| - Të tjera                  | 01/2012 – 01/2017 |

Në përfundim të procedurës së kontrollit është nxjerrë nga ana e inspektorit të kontrollit Projekt Raporti i Kontrollit sipas parashikimeve të nenit 83 pika 1 të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili i është dërguar tatimpaguesit me shkresën përcjellëse me nr.\_\_\_\_, datë 27.06.2017 nëpërmjet shërbimit postar dhe nuk rezulton të jetë kthyer zarfi nga ana e postës. Nga ana e subjektit, pas marrjes dijeni mbi konstatimet dhe rezultatet e Projekt Raport Kontrollit është paraqitur observacion, i cili është protokolluar në DRT Elbasan me shkresën nr.\_\_\_\_ Prot., datë 06.07.2017, duke paraqitur kundërshtimet dhe pretendimet e tij në lidhje me kontrollin e realizuar. Sipas përcaktimeve ligjore të **nenit 83 pika 4** të Ligjit 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, tatimpaguesi ka të drejtë të paraqesë kundërshtimet e tij me shkrim në lidhje me rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi. Më pas nga ana e organit tatimor sipas referimeve ligjore të **nenit 83 pika 6** të Ligjit 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është vijuar me nxjerrjen e Raportit Përfundimtar të Kontrollit Tatimor më datë 07.07.2017 i cili i është komunikuar tatimpaguesit me shkresën nr.\_\_\_\_ Prot., datë 11.07.2017 ku janë përshkruar shkeljet e konstatuara. Rezulton e provuar nga libri i postës datë 11.07.2017 të DRT Elbasan se shkresa nr.\_\_\_\_ Prot., datë 11.07.2017 i është dërguar subjektit nëpërmjet shërbimit postar në adresën e deklaruar në organin tatimor dhe nga ana e postës nuk është kthyer zarfi.

Në referim të Raport Kontrollit Përfundimtar ka dalë Njoftim Vlerësimi nr. \_\_\_\_ Prot., datë 11.07.2017, nxjerrë nga D.R.T. Elbasan në vlerën \_\_\_\_ lekë dhe Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr.\_\_\_\_ Prot., datë 14.09.2017 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan për detyrime në vlerën \_\_\_\_ lekë.

Detyrimet e mësipërme janë objekt kundërshtimi në objektin e padisë së paditësit duke pretenduar ndër të tjera *konstatimin e Pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore Nr.\_\_\_\_ Prot., datë 11.07.2017 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan për detyrime në vlerën \_\_\_\_ lekë.*

## **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në vendimin e saj nr. \_\_\_\_\_, datë 26.06.2024 vendosi rrëzimin e padisë. Gjykata ka vlerësuar se akti administrativ objekt gjykimi Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. \_\_\_\_ Prot., datë 11.07.2017, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan dhe Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimor nr. \_\_\_\_ Prot., datë 14.09.2017, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan është nxjerrë nga një organ administrativ tërësisht i identifikuar dhe brenda kompetencës së tij. Ligjvënësi ka përcaktuar qartë që administrata tatimore ka detyrimin e nxjerrjes së njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore, referuar nenit 5/1/a të Ligjit me Nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Ligjvënësi ka përcaktuar organin përkatës i cili kryen vlerësim dhe vendos në lidhje me ekzistencën ose jo të detyrimit tatimor, organ i cili është Drejtoria Rajonale Tatimore përkatëse e vendit të ushtrimit të aktivitetit të tatimpaguesit. Gjykata ka vlerësuar se nga aktet e dosjes gjyqësore ka rezultuar se njoftim vlerësimi tatimor është nxjerrë nga pala e paditur në respektim të procedurës së parashikuar nga ligji. Si rezultat i kontrollit të ushtruar ndaj tatimpaguesit është nxjerrë raport kontrolli, i cili është pasuar më pas me Njoftim Vlerësimet përkatëse për Detyrimet Tatimore.

Në lidhje me procedurën e kryerjes së vlerësimit tatimor, gjykata ka vlerësuar se, administrata tatimore ka ndjekur procedurat e përcaktuara në ligj, duke njoftuar tatimpaguesin brenda 10 ditëve nga momenti që ka dalë ky njoftim vlerësim. Në kushtet kur gjatë kontrollit të ushtruar janë konstatuar shkelje të legjislacionit tatimor dhe mbi këtë bazë është mbajtur edhe raporti i kontrollit, i cili i është njoftuar tatimpaguesit dhe ky i fundit ka paraqitur kundërshtimet e tij (observacionin), duke u vijuar më pas me nxjerrjen e njoftim vlerësimit, i cili po ashtu i është komunikuar tatimpaguesit, vlerësohet nga gjykata se të gjithë veprimet e kryera nga pala e paditur DRT Elbasan për nxjerrjen e aktit administrativ objekt gjykimi janë në përputhje me procedurën e përcaktuar nga ligji dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit.

Në lidhje me formën e akteve, Gjykata vlerëson se këto të fundit janë nxjerrë në përputhje me formën e parashikuar nga ligji nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 69/2. Nga ana e Gjykatës argumentohet se njoftim vlerësimet për detyrimet tatimore, përmbajnë emrin e organit publik që i ka nxjerrë, palën së cilës i drejtohet akti, datën e miratimit, pjesën arsyetuese, si dhe bazën ligjore ku është mbështetur nxjerrja e akteve administrative, pra të gjithë elementët e detyrueshëm të parashikuar nga ligji i posaçëm dhe Kodi i Procedurave Administrative.

## **Vendimi i Gjykatës:**

- 1. Rrëzimin e kërkesëpadisë së palës paditëse shoqëria “G.P” si të pabazuar në ligj dhe në prova.*
- 2. Shpenzimet procedurale gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*
- 3. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim bazuar në nenin 45 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.*

8. **Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 05.03.2025, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria “IIR & G” shpk me NIPT: L\_\_\_\_\_

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan

**Objekti:** Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore Nr.\_\_\_\_ Prot., datë 08.08.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, detyrim gjorbë në shumën \_\_\_\_ lekë.

**Shuma e detyrimit tatimor:** Njoftim Vlerësimi për Detyrimin Tatimor nr.\_\_\_\_ Prot., datë 08.08.2018, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, për detyrime në shumën totale \_\_\_\_ lekë.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 1, 2, 6, 33, 37, 38, 54, 69 e vijues; Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenet 1, 2, 3/1/a, 4, 5, 13, 14, 15, 18, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 84, 87, 99, 100, 107, 109, 113, 116, 117/2; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Në datën 04.07.2018, në Shëngjin, në zbatim të Urdhrit të Punës me nr.\_\_\_\_ Prot., datë 03.07.2018, inspektorët e zbatimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni Verior kanë ushtruar kontroll ndaj shoqërisë “IIR & G” sh.p.k. Kontrolli është bërë në automjetin me targa AA\_\_\_\_K të përfaqësuar nga z. A.P me dokument identifikimi ID I\_\_\_\_\_.

Për gjetjet e konstatuara është mbajtur në vend Akt–Konstatimi me nr. \_\_\_\_\_, datë 04.07.2018, në të cilin është evidentuar se:

- Subjekti është i regjistruar në QKB me NIPT L\_\_\_\_\_ dhe me targë AA\_\_\_\_K.
- Në momentin e kontrollit në punë u gjend z. A.P me dokument identifikimi ID I\_\_\_\_\_.
- Subjekti nuk disponon faturë tatimore për Mozzarella Tritata 4 (copë).
- Subjekti nuk disponon bllok faturash tatimore për të bërë autofaturë.

Nga ana e inspektorëve të Sektorit të Zbatimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni Verior, është mbajtur Akt–Konstatimi në vend me nr. \_\_\_\_\_, datë 04.07.2018, në të cilin është evidentuar shkelja administrative dhe Procesverbali i Gjorbës me nr.\_\_\_\_, datë 04.07.2018, me anë të të cilit subjekti është penalizuar me gjorbë në vlerën \_\_\_\_ lekë për mosmbajtje dokumentacioni në referim të **nenit 118** të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Në kushtet ku subjekti ka status ligjor organizimi shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe ka të ngarkuar përgjegjësitë tatimore si: kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatim në burim, tatim mbi vlerën e shtuar, tatim mbi fitimin, subjekti është i klasifikuar si biznes i madh prandaj dhe penalizimi është bërë në masën \_\_\_\_ lekë sipas nenit 118. Si rrjedhojë e akt-konstatimit të

mbajtur në tatimpaguesin shoqëria "IIR & G" sh.p.k është nxjerrë nga DRT Elbasan, Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore.

Duke qenë se subjekti "IIR & G" sh.p.k me nipt L \_\_\_\_\_ është i regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan që nga viti 2015, nga kjo e fundit është nxjerrë Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. \_\_\_\_ Prot., datë 08.08.2018. Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. \_\_\_\_ Prot., datë 08.08.2018 është një akt administrativ i hartuar, në zbatim të Akt Konstatimit me nr. \_\_\_\_\_, datë 04.07.2018, akt që ka rezultuar nga kontrolli i ushtruar nga inspektorët e Sektorit të Zbatimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor. Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore është një akt tërësisht i bazuar në procedurën që parashikon ligji nr.9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tyre.

Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, ka vepruar konform procedurave ligjore, në interpretim dhe në zbatim të ligjit dhe nuk ka bërë asnjë shkelje të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative.

#### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nëpërmjet vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 05.03.2025 vendosi rrëzimin e padisë. Gjykata ka vlerësuar se akti administrativ objekt gjykimi Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. \_\_\_\_ Prot., datë 08.08.2018, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan është nxjerrë nga një organ administrativ tërësisht i identifikuar dhe brenda kompetencës së tij. Ligjvënësi ka përcaktuar qartë që administrata tatimore ka detyrimin e nxjerrjes së njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore, referuar nenit 5/1/a të Ligjit me nr.9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Gjykata ka vlerësuar se nga aktet e dosjes gjyqësore ka rezultuar se njoftim vlerësimi tatimor është nxjerrë nga pala e paditur në respektim të procedurës së parashikuar nga ligji. Në lidhje me afatin e nxjerrjes së aktit njoftim vlerësim për detyrimet, Gjykata vlerëson se neni 69 i ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nuk disponon afat në nxjerrjen e njoftim vlerësimi por disponon afat në lidhje me njoftimin e njoftim vlerësimi, i cili duhet t'i komunikohet tatimpaguesit brenda 10 ditëve nga momenti që ka dal ky njoftim vlerësim.

Në lidhje me formën e aktit, njoftim vlerësim për detyrimet tatimore nr. \_\_\_\_ Prot., datë 08.08.2018, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan është nxjerrë në përputhje me formën e parashikuar nga Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 69/2. Gjykata ka vlerësuar se njoftim vlerësim për detyrimet tatimore, përmban emrin e organit publik që e ka nxjerrë, palën së cilës i drejtohet akti, datën e miratimit, pjesën arsyetuese, si dhe bazën ligjore ku është mbështetur nxjerrja e akteve administrative, të gjithë elementët e detyrueshëm të parashikuar nga ligji i posaçëm dhe Kodi i Procedurave Administrative.

## **Vendimi i Gjykatës:**

- *Rrëzimin e kërkesëpadisë së palës paditëse shoqëria “IIR & G” si të pabazuar në ligj dhe në prova.*
- *Shpenzimet procedurale gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*
- *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim bazuar në nenin 45 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

## **9. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 22.05.2024, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**

**Paditës:** B.LI, Person Fizik

**I paditur:** Drejtorja Rajonale Tatimore Elbasan

**Objekti:** Shuarjen e detyrimit prej \_\_\_\_\_ lekë gjoba dhe interesa, për mospajisje me kasë fiskale për herë të parë në vlerën \_\_\_\_\_ mijë lekë dhe vendimin e dënimit me gjobë për mospajisje me kasë fiskale për herë të parë në vlerën \_\_\_\_\_ mijë lekë, njoftuar sipas njoftimit dhe kërkesës për t’u paguar nr.\_\_\_\_, datë 21.08.2015, për efekt të parashkrimit.

**Baza ligjore:** Neni 46 i Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; neni 100 i Ligjit nr.9920 datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Ndaj tatimpaguesit B.LI është ushtruar kontroll në datë 11.07.2011 nga ana e inspektorëve të kontrollit, të Sektorit të Verifikimit në Terren në Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan. Gjatë kontrollit të ushtruar është mbajtur Akt Konstatimi me Nr. \_\_\_\_\_, datë 11.07.2011, nga ku rezulton se subjekti nuk është i pajisur me kasë fiskale, si dhe Proces-Verbal Gjobe nr.\_\_\_\_, datë 11.07.2011, nëpërmjet të cilit subjekti është penalizuar me gjobë në masën \_\_\_\_\_ lekë sipas parashikimeve ligjore të nenit 122 pika 1 gërma “a” të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, nga ana e DRT-Elbasan është nxjerrë Njoftim Vlerësimi për detyrimin tatimor, i cili i është komunikuar tatimpaguesit dhe kjo rezulton e provuar nga libri i shkresave hyrëse/dalëse të DRT-Elbasan të datës 15.08.2011.

Gjithashtu ndaj tatimpaguesit është ushtruar sërish kontroll në datë 03.09.2012 nga ana e inspektorëve të kontrollit, Sektori i Verifikimit në Terren në Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan, ku është mbajtur dhe Akt Konstatimi nr.\_\_\_\_, datë 03.09.2012, sipas së cilit subjekti nuk është i pajisur me kasë fiskale si dhe është mbajtur Proces-Verbal Gjobe Nr. \_\_\_\_\_, datë 03.09.2012 nëpërmjet të cilit subjekti është penalizuar me

gjobë në masën \_\_\_\_\_ lekë sipas parashikimeve ligjore të nenit 122 pika 1 gërma “a” të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, nga ana e DRT-Elbasan është nxjerrë Njoftim Vlerësimi për detyrimin tatimor, i cili i është komunikuar tatimpaguesit dhe kjo rezultoi në provuar nga libri i shkresave hyrëse/dalëse të DRT-Elbasan të datës 19.09.2012.

Paditësi ka pretenduar konstatimin e parashkrimit të ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative, me argumentin ligjor se kanë kaluar 5 vite nga vendosja e dy gjobave( të nxjerra në vitin 2011-2012) të cilat nuk janë ekzekutuar dhe konstatohet se vendimet për dënimet administrative janë parashkruar, sipas nenit 46 të Ligjit Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Pala paditëse pretendon se është parashkruar edhe e drejta për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese pasi kanë kaluar 5 vite nga dita e vendosjes së gjobave, dhe se masat shtrënguese janë ndërmarrë nga administrata tatimore në tejkallim të afateve ligjore duke referuar nenin 100 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” në nenin 46 të tij parashikon parashkrimin e dënimeve administrative, ku konkretisht përcakton: *Me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe, dënimi administrativ, i nxjerrë nga organi i administratës publike, i cili nuk ekzekutohet me kalimin e dy viteve nga data e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, parashkruhet. Në këtë rast, organi administrativ, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative, me vendim konstaton parashkrimin. Në vendimin, ku konstatohet parashkrimi i dënimit administrativ, listohen edhe arsyet që kanë çuar në këtë përfundim.*

Në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili është dhe ligji i posaçëm në rastin konkret, nuk parashikohet mundësia e parashkrimit të ekzekutimit të detyrimit tatimor me kalimin e një periudhe kohe të caktuar. Ky ligj, në nenin 111, pika 4 të tij parashikon vetëm kur mund të hiqen gjobat e vendosura për shkelje tatimore administrative, konkretisht: *4. Gjobat e vendosura për shkelje tatimore administrative mund të hiqen në rrethana të jashtëzakonshme, kur moszbatimi i legjislacionit tatimor është shkaktuar nga fatkeqësi natyrore apo rrethana të tjera, të jashtëzakonshme, si vdekja ose një sëmundje e rëndë e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron në përputhje me udhëzimet me shkrim të administratës tatimore.*

Duke qenë se nga ana e paditësit nuk është paguar detyrimi tatimor, ndaj tij ka filluar zbatimi i masave shtrënguese brenda afatit ligjor 5 vjeçar, të përcaktuar në nenin 100 pika 1 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nëpërmjet vendimit nr.\_\_\_\_\_, datë 22.05.2024 ka vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata ka vlerësuar qëndrimin e palëve në raport me dispozitat ligjore, ku paditësi referon në ligjin e përgjithshëm për kundërvajtjet administrative dhe pala e paditur në ligjin e posaçëm për procedurat tatimore, si dhe rrethanat faktike, ku u vërtetua gjyqësisht se procesverbali i parë i gjobës mban datën 11.07.2011 dhe procesverbali i dytë i gjobës mban datën 03.09.2012, ndërsa procedurat e ekzekutimit të masave shtrënguese ndaj paditësit kanë filluar në datë 21.08.2015 sipas shënimeve në sistemin tatimor C@ts dhe shkresës nr.\_\_\_\_\_ Prot., datë 21.08.2015.

Sipas Gjykatës, në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e ligjit të posacëm, konkretisht të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që parashikon se procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor mund të fillojnë brenda afatit 5 vjeçar nga momenti kur detyrimi tatimor duhej të paguhej. Gjykata ka arritur në konkluzionin se e drejta e administratës tatimore për të filluar procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm nuk është parashkruar, në kushtet kur detyrimi ka lindur në vitin 2011 dhe procedurat për vjeljen e tij kanë nisur në vitin 2015. Kjo gjen mbështetje edhe në faktin se vetë ligji i përgjithshëm, “Për kundërvajtjet administrative”, ka referuar tek dispozitat e ligjeve të veçanta dhe vetëm në rastet kur nuk ka dispozita të tilla do të gjejnë zbatim dispozitat e përgjithshme.

### **Vendimi i Gjykatës:**

1. *Rrëzimin e kërkesëpadisë së palës paditëse B.Ll si të pabazuar në ligj dhe në prova.*
2. *Shpenzimet procedurale gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*
3. *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim bazuar në nenin 45 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

### **10. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 20.11.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë**

**Paditës:** A.V, administrator i subjektit “N” sh.p.k, me NIPT K\_\_\_\_\_.

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë  
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Apelit Tatimor

**Objekti:** Anulimin e akteve administrative, Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore “Gjobë” nr.\_\_\_\_ Prot., datë 31.10.2011 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë dhe vendimit nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 10.12.2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

**Shuma e detyrimit tatimor:** \_\_\_\_\_ lekë

### **Baza Ligjore:**

- Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 119, pika 1, gërma a), neni 122, pika 1, gërma b);
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pika 80.3 gërma c), 108.5;
- Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- Kodi i Procedurave Administrative;
- Ligji nr. 10279/2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

## **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Me Njoftim Vlerësimin për detyrimet nr. \_\_\_\_ Prot., datë 31.10.2011 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, shoqëria "N" sh.p.k me adresë: Uji i Ftohtë, Vlorë, është ngarkuar për pagimin e detyrimit tatimor "gjobë" në shumën \_\_\_\_ lekë. Detyrimi rezulton të jetë vendosur në bazë të akt konstatimit nr.\_\_\_\_, datë 04.09.2011 të mbajtur nga inspektorët e Drejtorisë së Hetimit Tatimor (Task-Forcë) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në përfundim të ushtrimit të kontrollit në vendin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë. Sipas akt konstatimit rezulton se për tetë çadra dielli për pushues, grupi i kontrollit nuk ka konstatuar lëshimin e kuponit tatimor nga subjekti i kontrolluar, shoqëria "N" shpk. Akti i konstatimit rezulton të jetë nënshkruar nga paditësi.

Akti i konstatimit i është përcjellë me shkresën nr. \_\_\_\_ Prot., datë 08.09.2011 për veprime të mëtejshme Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë. Kjo e fundit, sipas shkresës nr. \_\_\_\_ Prot., datë 16.09.2011 vë në dijeni Drejtorinë e Hetimit Tatimor se në lidhje me këtë akt konstatimi ka kryer verifikimet në lidhje me punëmarrësit e gjetur në subjekt nga ku ka rezultuar se të gjithë punëmarrësit janë deklaruar sipas formularit Esig 027/a, ndërsa në lidhje me moslëshimin e kuponit tatimor ka kërkuar sqarime përse i përket konstatimit në akt, nëse subjekti nuk ka prerë kupona apo ato nuk janë gjetur tek klientët. Në përgjigje, Drejtoria e Hetimit Tatimor i ka bërë me dije me shkresën nr.\_\_\_\_ Prot., datë 10.10.2011 se: "ju sqarojmë se për tetë çadra subjekti nuk ka lëshuar kupon tatimor dhe për këtë arsye kemi kërkuar nga DRT Vlorë të zbatohet neni 122, pika l, gërma "b" e legjislacionit tatimor".

Bazuar në sa më sipër, DRT Vlorë ka njoftuar shoqërinë paditëse "" sh.p.k, me Njoftim Vlerësimin nr. \_\_\_\_ Prot., datë 31.10.2011, për detyrime tatimore "Gjobë" në shumën \_\_\_\_ lekë për moslëshim kuponi tatimor për tetë çadrat, referuar konstatimit të bërë nga grupi i kontrollit task forcë.

Pas ankimit të shoqërisë në rrugë administrative, Drejtoria e Apelit Tatimor ka vlerësuar të drejtë penaltetin dhe me shkresën nr. \_\_\_\_ Prot., datë 20.12.2011 njofton palën paditëse dhe DRT Vlorë për lënien në fuqi të Njoftim Vlerësimit tatimor nr. \_\_\_\_ Prot., datë 31.10.2011 në shumën \_\_\_\_ lekë.

## **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se konkluzioni i Gjykatës së Shkallës së Parë se paditësi nuk e ka kryer shkeljen është në interpretim të gabuar të ligjit dhe i pabazuar në provat dhe faktet e vërtetuara në këtë gjykim.

Rezulton se gjatë gjykimit në shkallë të parë pala e paditur ka provuar faktin se paditësi/ subjekti tatimpagues nuk ka lëshuar kupon tatimor, për tetë çadra dielli për pushues, në kundërshtim me parashikimet e nenit 122 të ligjit nr. 9920/2008, si dhe akt konstatimi është i rregullt në formë dhe në përmbajtje dhe ka vlefshmëri të plotë juridike për faktet e pasqyruara në to.

Gjykata Administrative e Apelit thekson faktin se referuar nenit 35 të ligjit 49/2012, organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, të nxjerë me iniciativë të tij.

Ky është një moment i rëndësishëm për tu mbajtur parasysh në gjykimin e posaçëm administrativ, pasi në këtë rast ligjshmëria e veprimtarisë administrative (në çdo formë qoftë ajo) është detyrim për

tu provuar nga pala e paditur organ publik. Edhe bazuar në nenin 26 të ligjit "Për kundërvajtjet administrative" barra e provës në kundërvajtjen administrative bie mbi organin e administratës publike që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.

Gjykata çmon të theksojë se organi publik palë e paditur mundi të vërtetojë gjatë gjykimit ligjshmërinë e aktit administrativ objekt kundërshtimi, pasi provoi me prova bindëse dhe të pakundërshtueshme se subjekti paditës ka kryer shkelje të ligjit duke mos lëshuar kupon tatimor. Për rrjedhojë, gjoba e vendosur ndaj palës paditëse, për moslëshim kuponi tatimor, gjen mbështetje në nenin 122 të ligjit nr. 9920/2008 dhe aktet administrative objekt gjykimi janë akte administrative të ligjshme dhe të themeltë, të nxjerrë në përputhje me dispozitat ligjore.

Në përfundim, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është rrjedhojë e analizës së gabuar të provave dhe interpretimit dhe zbatimit jo korrekt të ligjit material, për rrjedhojë shkaqet e ngritura në ankim nga pala e paditur qëndrojnë dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë duhet të ndryshohet, duke u vendosur rrëzimi i padisë, si i pambështetur në ligj dhe në prova.

### **Vendimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 12.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Rrëzimin e kërkesëpadisë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.
- Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs.

### **11. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 15.07.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë**

**Paditës:** "D" sh.p.k, NIPT K \_\_\_\_\_

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës

**Objekti:** Detyrimi i të paditurit të fshijë nga kontabiliteti detyrimin tatimor në shumën \_\_\_\_\_ lekë, detyrim ky i falur me ligjin nr. 9986, datë 11.09.2008 "Për faljen e detyrimeve tatimore e doganore" dhe ligjin nr. 10418, datë 21.04.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e detyrimeve tatimore e doganore".

**Shuma e detyrimit tatimor:** \_\_\_\_\_ lekë

**Baza Ligjore :**Neni 32/a i Kodit të Procedurës Civile, nenet 18/b, 137/3 të Kodit të Procedurës

Administrative, vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 01, datë 26.11.2012, ligji nr. 9986/2008 dhe ligji nr. 10418/2011 për kohën në fuqi, ligji nr. 9920/2008.

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Paditësi, shoqëria “D” sh.p.k., është shoqëri tregtare e të drejtës shqiptare, me NIPT K\_\_\_\_\_, me objekt aktiviteti në fushën e transportit urban, e regjistruar nën juridiksionin tatimor të palës së paditur Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

Në bazë të kontrollit tatimor të ushtruar nga pala e paditur pranë paditësit, me Njoftim Vlerësimin e detyrimeve nr. \_\_\_\_\_, datë 29.01.2007, pala paditëse detyrohet të paguajë shumën \_\_\_\_\_ lekë.

Kundër këtij akti paditësi fillimisht ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, e cila me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 27.03.2007, ka vendosur “rrezimin e kërkesës për apelim tatimor”.

Pas ezaurimit të rrugës administrative, pala paditëse, kundër këtij vendimi dhe Njoftim Vlerësimit të detyrimeve nr.\_\_\_\_\_, datë 29.01.2007, ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 11.10.2007, ka vendosur “Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor”. Mbi bazën e ankimit të veçantë ushtruar nga paditësi, Gjykata e Lartë, me vendimin nr.\_\_\_\_\_, datë 12.06.2008 ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 11.10.2007, të Gjykatës së Rrethit Durrës”.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9986, datë 11.09.2008 “Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore”, faleshin të gjitha detyrimet tatimore dhe shoqëria paditëse (si subjekt përfitues sipas nenit 2) ka paguar principalin e detyrimeve të njoftuara me Njoftim Vlerësimin e detyrimeve \_\_/2007, duke aplikuar për faljen e gjobave dhe kamatëvonesave pjesë e këtij akti.

Po ashtu, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10148, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor” (i ndryshuar me Aktin Normativ nr. 5, datë 28.12.2011 sa i përket afatit kohor të shtrirjes për faljen e borxhit tatimor/doganor, i shtyrë deri më datë 31.03.2012), faleshin detyrimet tatimore dhe paditësi përsëri ka aplikuar për faljen e tyre.

Në këto rrethana paditësi i është drejtuar Gjykatës me padi përmes së cilës ka kërkuar detyrimin e të paditurve të fshijnë nga kontabiliteti detyrimin tatimor në shumën \_\_\_\_\_ lekë.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.\_\_\_\_\_, datë 05.03.2013, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit “D” sh.p.k.*
- *Detyrimin e palës së paditur Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës të fshijë nga kontabiliteti detyrimin tatimor në shumën \_\_\_\_\_ lekë, detyrim ky i falur me ligjin nr. 9986, i vitit 2008 “Për faljen e detyrimeve tatimore doganore” dhe ligjin nr. 10418, i vitit 2011 “Për*

*legalizimin e kapitalit dhe faljen e detyrimeve tatimore doganore”.*

Në marrjen e këtij vendimi gjykata ka arsyetuar se sipas të dy ligjeve, ligjit nr. 9986, datë 11.09.2008 “Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore” dhe ligjit nr. 10148, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”, nuk përfitojnë nga dispozitat e tyre ata persona juridikë, detyrimi i të cilëve është përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Vendimi nr. \_\_\_\_\_, datë 11.10.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nuk e ka zgjidhur çështjen në themel, pasi ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit. Për pasojë nuk përbën një vendim të formës së prerë në kuptimin substancial, pasi nuk është shprehur për meritat e çështjes. Gjithashtu, sipas Gjykatës pala paditëse i përmbush të gjitha kushtet për të përfituar nga falja e detyrimeve tatimore.

**Kundër vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 05.03.2013,** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka bërë ankim pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe rrëzimin e padisë.

**Gjykata e Apelit Durrës,** me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 28.04.2014, ka vendosur: *Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Durrës për gjykimin e çështjes. Dërgimin e akteve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë si gjykatë kompetente.*

**Gjykata Administrative e Apelit,** me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 07.04.2015, ka vendosur: *Prishjen e vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 05.03.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe pushimin e gjyimit të çështjes.*

Në marrjen e këtij vendimi gjykata ka arsyetuar se ndodhemi përpara një padie që nuk mund të ngrihet pasi pala paditëse duhet, që në objektin e padisë së saj, të kishte kundërshtuar shkresën nr. \_\_\_\_\_, datë 02.11.2012, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, si akti administrativ me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij.

**Kundër vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 07.04.2015,** të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala paditëse, Shoqëria “D” sh.p.k, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe lënien në fuqi të vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 05.03.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**Gjykata e Lartë, me vendimin Nr. \_\_\_\_\_, datë 08.06.2017** ka Vendosur: *Prishjen e Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. \_\_\_\_\_, datë 07.04.2015 dhe kthimin për rigjykim në po atë gjykatë, me trupë tjetër gjykuese.*

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit, gjatë shqyrtimit të çështjes, analizimit të akteve të paraqitura nga palët dhe argumentimit të pretendimeve të secilës prej tyre, ka konkluduar se vendimi i dhënë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. \_\_\_\_\_, datë 05.03.2013, është i bazuar dhe argumentuar në ligj, për pasojë duhet të lihet në fuqi. Kjo për faktin se pala paditëse në objektin e padisë së saj ka paraqitur shumë qartë se nuk kundërshton një akt administrativ, por kërkon të klasifikohet si tatimpagues nën efektin e Ligjit nr. 9986, datë 11.09.2008 “Për faljen e detyrimeve doganore dhe

tatimore” dhe ligjit nr. 10148, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”.

Për aq kohë sa evidentohet se nga ana e tatimpaguesit, janë përmbushur kriteret për t’u përfshirë në efektet e këtij ligji, duke paguar detyrimin tatimor, nuk ka bazë ligjore që të refuzohet falja e gjobave dhe kamatvonesave.

Në lidhje me pretendimin se ky tatimpagues nuk mund të përfshihet në procedurat e faljes, për faktin se ka një vendim të formës së prerë mbi aktin administrativ, konstatohet se Vendimi nr. \_\_\_\_\_, datë 11.10.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nuk e ka zgjidhur çështjen në themel, pasi ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit. Për pasojë nuk përbën një vendim të formës së prerë në kuptimin substancial, pasi nuk është shprehur për meritat e çështjes. Gjithashtu ajo ka arsyetuar se pala paditëse i përmbush të gjitha kushtet për të përfituar nga falja e detyrimeve tatimore.

### **Vendimi i Gjykatës:**

- Lënien në fuqi të Vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 05.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Durrës.

### **12. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 15.07.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë**

**Paditës:** “A” sh.p.k, NIPT K\_ \_\_\_\_\_

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës  
Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë

**Objekti:** Pavlefshmëri absolute e Njoftim Vleresimit Nr. \_\_\_\_\_ Prot., Datë 15.03.2016 dhe Vendimit te DAT Nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 06.07.2016.

**Shuma e detyrimit tatimor:** \_\_\_\_\_ lekë

**Baza Ligjore :** Nenet 31, 32, 35, 36 e vijues i KPC, nenet 116, 117 të KPA, nenet 69, 71, 72, 80, 81, 83, 84, 106, 107, 109 e vijues të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Bazuar në verifikimin e kryer nga strukturat e Verifikimit në Vend, është evidentuar se gjatë kontrollit të ushtruar në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të palës paditëse, në punë janë gjendur 3 punonjës, të identifikuar nga ana e strukturave të administratës tatimore me ID-të përkatëse në Akt Konstatim.

Nga ana e inspektorëve të DRT Durrës, është verifikuar deklarimi i tatimpaguesit mbi fuqinë punëtore, nga ku ka rezultuar se njëri prej personave të evidentuar në akt konstatim, ishte i larguar një ditë më parë nga puna nëpërmjet formularit ESIG-027, ndërkohë që rezultonte në mënyrë faktike, në punë, në ambientet e paditësit.

Për pasojë, nga DRT Durrës është lëshuar akti administrativ, Njoftim Vlerësimi Nr. \_\_\_\_ Prot., datë 15.03.2016, në shumën \_\_\_\_ lekë, për punonjës të padeklaruar.

Nga ana e palës paditëse, është kundërshtuar Njoftim Vlerësimi përkatës, pranë DAT, dhe ky organ, nëpërmjet Vendimit Nr. \_\_\_\_ Prot., datë 06.07.2016, ka vendosur Refuzimin e Ankimit, për shkak se rezulton që ankimi administrativ, është paraqitur jashtë afateve.

Më tej paditësi, është drejtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke kërkuar pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, me pretendimin se në fakt punonjësi i evidentuar në punë nga inspektorët, ka qenë duke kryer dorëzimet e punës dhe nga ana e tyre nuk mund të provohet në mënyrë të parevokueshme se vërtet ky punonjës është gjendur në punë.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës**, me vendimin Nr. \_\_\_\_, datë 31.05.2017, ka vendosur:

*Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit.*

#### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit, gjatë shqyrtimit të çështjes, analizimit të akteve të paraqitura nga palët dhe argumentimit të pretendimeve të secilës prej tyre, ka konkluduar se vendimi i dhënë nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me vendimin Nr. \_\_\_\_, datë 31.05.2017, është i bazuar dhe argumentuar në ligj e për pasojë duhet të lihet në fuqi. Kjo për faktin se, pala paditëse në kërkesëpadinë e paraqitur, pretendon faktin se punonjësi për të cilin është lëshuar penaliteti, në fakt nuk ndodhej duke punuar në ambientet e aktivitetit të tij, por nga ana tjetër nuk paraqet asnjë provë konkrete për të mbështetur pretendimet e tij. Ndërkohë që administrata tatimore, në akt-konstatimin e mbajtur, ka paraqitur të gjitha të dhenat e nevojshme dhe identifikuese të tatimpaguesit dhe punonjësve të evidentuar, gjë që provon për ushtrimin e duhur të diskrecionit të organit publik, në evidentimin e një shkelje të natyrës tatimore. Po kështu, pavarësisht se në objektin e padisë, pala paditëse kërkon dhe pretendon pavlefshmërinë absolute, nga pretendimet që ajo paraqet në argumentimin dhe kundërshtimin e aktit administrativ, evidentohet se pretendimet janë të natyrës së paligjshmërisë së aktit administrativ dhe jo të natyrës së pavlefshmërisë absolute. Në këto kushte pretendimet e paditësit gjenden të pa mbështetura ligjërisht.

#### **Vendimi i Gjykatës:**

- Lënien në fuqi të Vendimit nr.\_\_\_\_\_, datë 31.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

### 13. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 21.05.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

**Paditës:** D.A

**I paditur:** Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë

**Objekti:** - Detyrimin e palës së paditur të kryej çregjistrimin e përgjegjësisë tatimore për deklarimin e TVSH-së për paditësin si subjekt i biznesit të vogël dhe duke ngelur i regjistruar si biznes i vogël pa TVSH.

- Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore" datë 18.10.2016 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

**Shuma e detyrimit tatimor:** Në total detyrime për tvsh në vlerën \_\_\_\_ lekë.

#### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Tatimpaguesi është kontrolluar nga strukturat e DRT Korçë në periudha të ndryshme. Gjatë aktivitetit të tij ka pasur xhiro të deklaruar në vlera të konsiderueshme, për disa raste është penalizuar për mos lëshim të kuponit tatimor dhe të gjitha këto konstatime kanë cuar në ndryshimin e statusit dhe detyrimin e tatimpaguesit për të deklaruar tvsh.

Nga kontrollet e ushtruara pranë tatimpaguesit dhe bazuar në shkresën e DPT-së nr. \_\_\_\_ Prot., datë 29.09.2016, Drejtoria Rajonale Tatimore ka ndryshuar përgjegjësinë tatimore të tatimpaguesit duke ndryshuar statusin nga person fizik në person fizik me tvsh.

Procedura e ndryshimit të statusit dhe e kalimit person fizik me tvsh është bazuar në gjetjet e kontrolleve të ushtruara nga strukturat tatimore, lidhur me xhiron e realizuar nga tatimpaguesi, fuqinë punëtore të nevojshme për të përballuar fluksin e punës.

Paditësi i është drejtuar Gjykatës duke kërkuar çregjistrimin e përgjegjësisë tatimore për deklarimin e TVSH-së për paditësin si subjekt i biznesit të vogël dhe duke ngelur i regjistruar si biznes i vogël pa TVSH, si dhe shfuqizimin e njoftim vlerësimit tatimor për detyrimet e nxjerra nga DRT Korçë.

#### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 25.10.2017, ka vendosur: Pranimin e padisë, Shfuqizimin e njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të kryejë çregjistrimin e përgjegjësisë tatimore për deklarimin e TVSH-së për paditësin "DA" Person Fizik,

duke mbetur i regjistruar si biznes i vogël pa TVSH. Ky detyrim duhet të përmbushet nga debitori Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi dhe është një detyrim i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.

### **Vendimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit në lidhje ka vlerësuar se në çështjen objekt gjykimi jemi përpara një padie që nuk mund të ngrihet. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se me shkresën me nr.\_\_\_\_, datë 07.10.2016 DRT Korçë ka njoftuar paditësin për deklarimin e detyrimeve tatimore dhe regjistrimin si biznes i vogël me tvsh. Subjekti ka paraqitur kërkesë ankimore datë 05.11.2016 duke kërkuar ndryshimin e përgjegjësisë tatimore dhe çregjistrimin e tij si subjekt me TVSH. Pasi është vënë në dijeni për sa më sipër, pala paditëse ka ndjekur rrugën e ankimit administrativ pranë DPT Tiranë .

Në rastin konkret shkresa me nr.\_\_\_\_, datë 07.10.2016, e DRT Korçë nuk plotëson kushtet për tu klasifikuar akt administrativ, pasi ajo nuk krijon, ndryshon apo shuan një marrëdhënie juridike midis paditësit dhe të paditurit, por e njofton atë për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore në regjistrimin si biznes i vogël me tvsh .Rezulton se kemi të bëjmë vetëm me një njoftim dhe se nuk jemi përpara rastit të nxjerrjes së një akti administrativ Për përlllogaritje apo likuidim detyrimi. Gjykata e shkallës së parë ka gabuar vetëm në mënyrën e disponimit në lidhje me këtë kërkim pasi rezulton të jetë shprehur me vendim për pranimin e kërkesëpadisë edhe në lidhje me këtë kërkim.

### **14. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 15.05.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria T shpk

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë

**Objekti:** Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit Tatimor nr.\_\_\_\_, datë 25.04.2017 për gjobë TVSH nxjerrë nga pala e paditur

**Shuma e detyrimit tatimor:** \_\_\_\_\_ lekë

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit në datën 28.04.2017 është mbajtur procesverbal në lidhje me verifikimin e librave të shitjes, konkretisht deklarimin e shitjeve të kryera nga ana e subjektit.

Subjekti ka kryer shitje me pakicë në individë konsumatorë të cilat i ka regjistruar në librat e shitjes ndërkohë që subjekti rezulton i regjistruar si subjekt vetëm me një adresë kryesore.

Mbi llogaritjet e kryera/ pasqyruara në këtë procesverbal është nxjerrë akti administrativ Njoftim Vlerësimi Tatimor nr.\_\_\_\_, datë 25.04.2017 për gjobë TVSH në vlerën \_\_\_\_\_ lekë.

Tatimpaguesi ka kundërshtuar Njoftim Vlerësimin Tatimor në Drejtorinë e Apelit Tatimor, ku kjo e fundit ka vendosur lënien në fuqi të gjobës.

Paditësi i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimi Tatimor për detyrimet e nxjerra nga DRT Korçë.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 18.05.2018, arsyeton se në rastin konkret provohet plotësisht se njoftim-vlerësimi për detyrimet tatimore ka dalë nga organi i njohur nga ligji, në përputhje me kompetencat dhe sipas procedurës së caktuar, pas konstatimit të shkeljes tatimore të rezultuar nga shqyrtimi i të dhënave të deklaruara nga vetë tatimpaguesi, i cili përgjigjet për saktësinë e tyre, të materializuara në mënyrë të shprehur në dispozitat e ligjit të posacëm nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe udhëzimit në zbatim të tij, dhe nuk përmban asnjë element që do ta bënte absolutisht të pavlefshëm apo të paligjshëm. Nga ana tjetër, pala paditëse nuk solli prova për të vërtetuar se për periudhën objekt kontrolli ka kryer vetëm aktivitet të shitjes me shumicë, por ajo që u vërtetua gjatë gjykimit është fakti se subjekti ka shkelur një dispozitë detyruese të ligjit material dhe për këtë arsye është ndëshkuar me gjobë.

Gjykata Administrative e Apelit arsyeton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vlerësuar drejtë rrethanat e faktit. Në përfundim Gjykata Administrative e Apelit cmon se, vendimi nr. \_\_\_\_\_, datë 18.05.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë duhet lënë në fuqi, bazuar në gjermën b) të nenit 50 të ligjit 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Pra, sipas vlerësimit të Gjykatës, njoftim vlerësimi i nxjerre nga DRT Korçe është akt administrativ i ligjshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

**Vendimi i Gjykatës:** Gjykata Administrative e Apelit Tirane me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 15.05.2025, në përfundim të gjykimit vendosi:

- Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë (rrëzimin e kërkesëpadisë).
- Kundër vendimit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

### **15. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 12.03.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë**

**Paditës:** shoqëria “C” sh.p.k

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë; Drejtoria e Apelit Tatimor

**Objekti:** Shfuqizimi i aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi Tatimor” nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 09.09.2016, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë; Shfuqizimi i Vendimit nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 23.12.2016, i Drejtorisë së Apelit Tatimor.

**Shuma e detyrimit tatimor:** \_\_\_\_\_ lekë gjobë për punëmarrës të padekluar

## **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Shoqëria tregtare “C” sh.p.k., e regjistruar që prej vitit 2006, ushtron aktivitet tregtar dhe prej disa vitesh është distributor i shoqërisë “B” sh.a., fakt i provuar nga kontrata e furnizimit e datës 16.11.2015.

Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, në zbatim të urdhrit të punës nr. \_\_\_\_ Prot., datë 18.07.2016, kanë ushtruar kontroll në transport, ku është ndaluar mjete furgon me targë AA \_\_\_\_\_, në të cilin ndodhej shtetasi B. Z.

Sipas akt-kontrollit të datës 18.07.2016, u konstatua se:

- Mjeti ishte i deklaruar në organet tatimore dhe QKB;
- Malli shoqërohej me faturë tatimore dhe faturë shoqërimi;
- Mjeti ishte i pajisur me pajisje fiskale;
- Akti u mbajr rreth orës 11:30 dhe u firmos nga shtetasi B.Z.

DRT Lezhë, me Njoftim Vlerësimin Tatimor nr. \_\_\_\_ prot., datë 09.09.2016, bazuar në nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008, ka gjobitur shoqërinë paditëse me \_\_\_\_ lekë, duke e konsideruar shtetasin B.Z si punonjës të padeklaruar.

Shoqëria “C” sh.p.k. ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, e cila me vendimin nr. \_\_\_\_ prot., datë 23.12.2016, ka lënë në fuqi aktin e DRT Lezhë.

## **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 04.10.2017, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesëpadisë;*
- *Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimi Tatimor nr. \_\_\_\_ prot., datë 09.09.2016;*
- *Shfuqizimin e Vendimit nr. \_\_\_\_ prot., datë 23.12.2016 të DAT;*
- *Ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore palës së paditur.*

Gjykata ka arsyetuar ndër të tjera se:

Shtetasi B.Z nuk ishte punonjës i shoqërisë “C” sh.p.k., por i shoqërisë “B” sh.a., fakt i provuar nga listëpagesat e kontributeve shoqërore dhe kontrata e furnizimit. Prezenca e tij në mjet ishte legjitime, si specialist shitjesh i kompanisë prodhuese. DRT Lezhë ka vepruar jashtë objektit të urdhrit të punës, pasi kontrolli kishte si objekt dokumentacionin e mallrave dhe jo deklarimin e punonjësve.

Mbi bazën e ankimit të ushtruar nga ana e palës së paditur, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar ndër të tjera se:

Barra e provës për ligjshmërinë e aktit administrativ i takon organit publik, sipas nenit 35 të ligjit nr. 49/2012. Nga provat e administruara rezulton qartë se shtetasi B.Z ishte i punësuar pranë shoqërisë “B” sh.a. dhe jo pranë shoqërisë paditëse. DRT Lezhë nuk ka provuar ekzistencën e marrëdhënies së punës ndërmjet z. B.Z dhe shoqërisë “C” sh.p.k. Nuk është konsumuar kundërvajtja administrative e parashikuar nga neni 119 i ligjit nr. 9920/2008.

### **Vendimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. . \_\_\_\_\_, datë 12.03.2025, vendosi:

1. *Lënie në fuqi të vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 04.10.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër;*
2. *Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.*

### **16. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 13.11.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** Shoqëria tregtare “E” sh.p.k.

**E paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj

**Objekti:** Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore” nr. \_\_\_\_ Prot., datë 23.03.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Administrata tatimore ka ushtruar kontroll tatimor ndaj shoqërisë paditëse për periudha të ndryshme tatimore, duke konstatuar pamundësinë e kryerjes së kontrollit në vend për shkak të mosushtrimit të aktivitetit dhe mungesës së bashkëpunimit të subjektit. Për këtë arsye, është vendosur kryerja e vlerësimit tatimor nga zyra, bazuar në mënyrat alternative të parashikuara nga ligji.

Në përfundim të këtij vlerësimi është nxjerrë Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr. \_\_\_\_ Prot., datë 23.03.2017, me detyrime totale në vlerën \_\_\_\_\_ lekë.

Pala paditëse ka ankimuar këtë akt pranë Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore, i cili ka refuzuar ankimin për mosrespektim të afatit ligjor dhe mungesë të garancisë bankare.

## **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 30.10.2018, ka vendosur:

- 1. Rrëzimin e padisë së shoqërisë "E" sh.p.k. si të pabazuar në ligj dhe në prova.*
- 2. Ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore palës paditëse.*
- 3. Lejimin e ankimit kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Apelit.*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ndër të tjera ka arsyetuar se:

Pala paditëse ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, duke pretenduar shkelje të procedurës dhe cenim të së drejtës për t'u dëgjuar. Pavlefshmëria absolute kërkon shkelje të rënda dhe flagrante të ligjit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në nxjerrjen e aktit administrativ. Në rastin konkret, administrata tatimore ka respektuar procedurën e posaçme të parashikuar nga ligji nr. 9920/2008 dhe aktet nënligjore përkatëse.

Moskomunikimi paraprak i raportit të kontrollit nuk përbën shkak për pavlefshmëri absolute, pasi ligji parashikon mundësinë e rishikimit të vlerësimit tatimor sapo tatimpaguesi rregullon situatën e tij. Pala paditëse nuk ka provuar pamundësi objektive për bashkëpunim me administratën tatimore.

Në këto kushte, gjykata ka çmuar se nuk ndodhemi përpara një akti absolutisht të pavlefshëm.

Nga shqyrtimi i ankimit të paraqitur nga ana e palës paditëse, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar ndër të tjera se:

Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është i bazuar në ligj dhe në prova. Procedura e ndjekur nga administrata tatimore është në përputhje me ligjin nr. 9920/2008 dhe Udhëzimin nr. 24/2008. Nuk rezulton shkelje e rëndë dhe flagrante e ligjit që të çojë në pavlefshmëri absolute të aktit administrativ. Pala paditëse nuk ka provuar cenim real të së drejtës për t'u dëgjuar.

## **Vendimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 13.11.2025, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 30.10.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve nga komunikimi i vendimit të arsyetuar.*

**17. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 23.10.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** A.B, Person Fizik

**Të paditur:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë  
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

**Objekti:** “1.Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.\_\_\_\_, datë 18.05.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.  
2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të procesverbal konstatimit nr.\_\_\_\_, datë 20.04.2015 të mbajtur nga ana e inspektorit A.M të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.  
3.Zgjidhjen e pasojave si rezultat i konstatimit të kësaj pavlefshmërie absolute, duke shuar detyrimin tatimor të paditësit, referuar njoftim vlerësimit të detyrimit tatimor me shkresën nr.\_\_\_\_, datë 18.05.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në shumën prej \_\_\_\_ lekë si një detyrim tatimor që nuk ekziston.

**Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

A.B është subjekt tregtar në administrim të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër me numër NIPT-i K\_\_\_\_\_, me objekt aktiviteti “tregtim karburanti ...” .

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin me detyrime tatimore vlerësuar sipas njoftim-vlerësimit nr.\_\_\_\_, datë 18.05.2015, në të cilin janë pasqyruar në mënyrë të detajuar detyrimet sipas zërit përkatës tatimor dhe periudhave përkatëse tatimore.

Subjekti duke mos qenë dakord me këtë vlerësim të organit tatimor i është drejtuar me një kërkesë për apelim, Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

Drejtoria e Apelit Tatimor është përgjegjgur me vendimin e saj nr.\_\_\_\_, datë 26.08.2015, nëpërmjet të cilit vendosi:

- *Refuzimin e ankimit, pasi nuk është paguar detyrimi tatimor i përcaktuar në aktin administrativ, njoftim vlerësimit nr.\_\_\_\_, datë 18.05.2015 objekt ankimi.*

Duke mos qenë dakord as me vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor, tatimpaguesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me kërkesëpadinë me objekt si më sipër.

**Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr.\_\_\_\_, datë 10.01.2018 ka vendosur :

- *Rrëzimin e kërkesëpadisë në çështjen administrative nr.\_\_\_\_ akti, që është ngritur nga pala paditëse*

*subjekti tatimpagues person fizik A.B, si e pabazuar në ligj e në prova.*

*- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.*

*- Kundër këtij vendimi lejohet apel brenda 15 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes. Për palën e aktorët në mungesë, afati fillon nga dita e njoftimit të vendimit...*

Ndër të tjera, kjo gjykatë konsideron se kërkimi i palës së interesuar në lidhje me atë se çfarë po kërkohet konkretisht para gjykatës nuk lidhet thjesht e vetëm me fjalët që përdoren në objektin e padisë e me nenet që vendosen si bazë ligjore, por lidhet me të gjithë parashtrimin që bëhet në padi e në seancë, duke konsideruar nenin 5 për nenet 153 e vijues të K.Pr.Civile dhe në këtë drejtim kërkimi i palës paditëse është i paqartë e kontradiktor, në lidhje me atë se çfarë po kërkohet konkretisht para gjykatës, sepse nuk kemi një qëndrim të qartë se çfarë po kërkohet konkretisht para gjykatës, pasi kërkimi nuk referon në shkakun ligjor (apo edhe në bazën juridike të padisë).

Pala paditëse për të kërkuar pavlefshmerinë absolute të veprimeve konkrete apo të akteve konkrete që bëhet fjalë duhet t'i bëjë me dije gjykatës :

a) nëse bëhet fjalë vetëm për efekte procedurale, të drejtën ligjore procedurale se ku bazohet (ligjin procedural normën konkrete procedurale që i jep të drejtën) dhe

b) nëse bëhet fjalë edhe për të drejtën në themel, të drejtën ligjore se ku bazohet (ligjin material që i jep të drejtën materiale).

Pavlefshmëria apo për më tepër pavlefshmëria absolute, parashikohet në mënyrë të shprehur qartazi në normën konkrete ligjore dhe nuk mund të dalë apriori nga interpretimi i normës konkrete ligjore. Pala paditëse de jure kërkon pavlefshmeri absolute de fakto kërkon pavlefshmeri relative per aktin administrativ.

Në veprimet e palës së paditur DRT Shkodër, në mënyrën që trajtohen në padi e në seancë nga pala paditëse nuk gjendet ndonjë veprim i kundërligjshëm.

Akti administrativ i palës së paditur, konsiderohet legal dhe i themeltë, pasi ajo pala e paditur DRT Shkodër ka zbatuar legjislacionin përkatës.

Akti objekt gjykimi, Procesverbal konstatimi nr.\_\_\_\_, datë 20.4.2015 nuk është akt administrativ (ai akt, është një nga aktet që mund të mbahet gjatë procedurës administrative, deri në marrjen e aktit administrativ).

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e zhvilluara e për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, gjykata çmoi se, kërkimet e bëra nga pala paditëse në kërkesëpadi janë të pabazuara në ligj e në prova dhe si e tillë ajo duhet të vendosë rrëzimin e tyre.

- **Mbi ankimin e ushtruar nga ana e palës paditëse, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar si vijon:**

Edhe kjo gjykatë pas shqyrtimit të plotë të çështjes arrin në përfundimin se kërkesëpadia është e pabazuar, pasi nuk jemi përpara pavlefshmërisë absolute të akteve në kuptim të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative. Nga aktet rezulton, se akti "Njoftim vlerësimi për detyrimet" nr. \_\_\_\_ datë 18.05.2015 i DRT Shkodër është nxjerrë nga organi tatimor kompetent, brenda kufijve të kompetencës ligjore të përcaktuar në nenin 90 e vijues të ligjit nr. 9920/2008 dhe pas zhvillimit të procedurës administrative të parashikuar në nenin 103 të të njëjtit ligj. Nuk rezulton asnjë shkelje e formës apo e procedurës ligjore që të përbëjë shkak për pavlefshmëri absolute në kuptimin e nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjykata Administrative e Apelit vëren gjithashtu se, ashtu sikurse është arsyetuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, padia e paraqitur nuk ka përcaktuar qartë objektin dhe shkakun ligjor mbi të cilin mbështetet. Edhe pse gjykata ka ushtruar detyrimin e saj për të orientuar palën në sqarimin e objektit të padisë, paditësi nuk ka arritur të qartësojë atë. Parimi i disponibilitetit i parashikuar në nenin 3 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 16 të ligjit nr.49/2012 përcakton, se është detyrë e palës të përcaktojë objektin dhe shkakun e padisë, gjykata nuk mund të zevëndësojë palën në përmbushjen e këtij detyrimi procedural.

Në lidhje me pretendimin e paditësit për tejkalim të kompetencave nga ana e inspektoreve tatimore, gjykata konstaton se, nga aktet rezulton qartë që verifikimi është kryer në përputhje me nenin 91 të ligjit nr.9920/2008, që i jep administratës tatimore të drejtën për të kryer kontrole dhe për të bërë rivlerësim të detyrimeve në rast të mosrakordimeve të të ardhurave. Nuk rezulton që inspektorët të kenë ndërmarrë veprime jashtë kufijve të përcaktuar nga ligji apo që të kenë cënuar të drejtat procedurale si tatimpagues.

Po kështu i bazuar gjendet arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë sipas të cilit bazueshmëria e pretendimit të paditësit se diferencat e evidentuara midis sistemit SIT dhe kasave fiskale janë pasojë e defekteve teknike të pajisjeve fiskale NEXUS dhe jo rezultat i mospërputhjeve reale të të ardhurave ka të bëjë me ligjshmërinë e akteve pavlefshmërinë relative të tyre (sipas kuptimit të K.Pr.A të kohës) e cila nuk ka qenë objekt shqyrtimi.

Sipas Gjykatës Administrative të Apelit i bazuar gjendet arsyetimi i Gjykatës së Shkallës së Parë sipas të cilit Procesverbali i konstatimit nr. \_\_\_\_, datë 20.04.2015 i mbajtur nga ana e inspektorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, për të cilin pala paditëse ka pretenduar se është një akt administrativ, është i pabazuar.

Në përfundim Gjykata Administrative e Apelit çmon, se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka identifikuar saktë faktet dhe ligjin procedural dhe material, duke cilësuar dispozitat e detyrueshme për t'u zbatuar prej saj, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes dhe duke i interpretuar ato në mënyrë korrekte.

### **Vendimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit nr. \_\_\_\_, datë 23.10.2025, vendosi:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. \_\_\_\_, datë 10.01.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*

- Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs.

**18. Vendim nr. \_\_\_\_\_, datë 18.06.2025, Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** Shoqëria “H” shpk

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

**Objekti :** “1.Shfuqizimin e vendimit, shkresës nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 24.05.2018 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, e cila shprehet se “nuk jemi përfitues të ligjit nr.33/2017 për fshirjen e detyrimeve tatimore.

2.Detyrimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për të shuar detyrimet tatimore të përshkruara sipas njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 18.07.2014 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër ashtu siç e parashikon ligji nr.33/2017.

**Baza Ligjore :** Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, i ndryshuar, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Ligji nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e Kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.23 datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, Ligji nr.33/2017 “Për Pagesën dhe Fshirjen/Shuarjen e Detyrimeve Tatimore, Detyrimeve të Pagueshme në Doganë si dhe Procedurën e Heqjes nga Qarkullimi të Mjeteve të Transportit pas Fshirjes/Shuarjes së Detyrimeve Tatimore”, Udhëzimi Nr.14 datë 03.05.2017 për zbatimin e këtij ligji ...

**Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Shoqëria “H” sh.p.k është subjekt tregtar në administrim të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, si person juridik me NIPT K\_\_\_\_\_, me objekt aktiviteti “tregtim i artikujve të ndryshëm ...”

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin me detyrime vlerësuar sipas njoftim-vlerësimit nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 18.07.2014, gjobë në vlerën \_\_\_\_\_ lekë për “moslëshim të kuponit tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve”, në zbatim të ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 122 pika 1, gërma (b/i).

- Subjekti duke mos qenë dakord me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë me një kërkesë ankimore në lidhje me të.

Drejtoria e Apelit Tatimor është përgjigjur me vendimin e saj nr. \_\_\_\_\_, datë 04.12.2014, nëpërmjet të cilit vendos :

- *Refuzimin e ankimit ndaj aktit administrativ njoftim vlerësimi nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 04.09.2014 nxjerrë nga D.R.T-ve Shkodër, pasi është dorëzuar jashtë afateve ligjore.*

Subjekti pretendon për sanksione në vlerë totale \_\_\_\_\_ lekë, për “moslëshim të kuponit tatimor” dhe për “mosdeklarim punonjësi”.

- Me njoftim vlerësimin tatimor nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 06.08.2014 subjekti është vlerësuar me dënim dy gjoba, për punonjës të padeklaruar në vlerën totale prej \_\_\_\_\_ lekë, bazuar në ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 119, pika 1, gërma (a).
- Subjekti duke mos qenë dakord me këtë vlerësim të organit tatimor i është drejtuar me një kërkesë për apelim, Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

Drejtorja e Apelit Tatimor është përgjegjës me vendimin e saj nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 04.12.2014, nëpërmjet të cilit vendos:

- *Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. \_\_\_\_\_ prot datë 06.08.2014 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër për gjobën në vlerën prej \_\_\_\_\_ lekë për mosdeklarimin e të punësuarve pranë organit tatimor.*

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, është adresuar për gjykim çështja me palë paditëse shoqëria “H” sh.p.k, palë e paditur Drejtorja Rajonale e Tatimeve Shkodër dhe me objekt gjykimi:

- 1 - Shfuqizimin e aktit administrativ, përkatësisht njoftim vlerësimi për detyrime tatimore nr. \_\_\_\_\_ prot datë 18.07.2014 si akt administrativ relativisht i pavlefshëm.
- 2 - Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akt konstatimit nr. \_\_\_\_\_, datë 01.08.2014;
  - Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit, përkatësisht Proçesverbalit nr. \_\_\_\_\_ datë 01.08.2014;
  - Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ njoftim vlerësimi nr. \_\_\_\_\_ prot datë 06.08.2014.
- 3 - Detyrimin e palës së paditur mbi shpenzimet gjyqësore”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në lidhje me këtë çështje doli me vendimin e saj nr. \_\_\_\_\_, datë 28.12.2016 nëpërmjet të cilit vendosi:

- Pushimin e gjykimit të çështjes. (Vendim i formës së prerë).

Subjekti i drejtohet gjykatës tani sipas objektit të kërkimit në këtë gjykim.

Ligji Nr.33/2017 “Për Pagesën dhe Fshirjen/Shuarjen e Detyrimeve Tatimore, Detyrimeve të Pagueshme në Doganë si dhe Procedurën e Heqjes nga Qarkullimi të Mjeteve të Transportit pas Fshirjes/Shuarjes së Detyrimeve Tatimore” është miratuar në datën 30.3.2017, shpallur me dekretin nr.10142 datë 19.4.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, botuar në Fletoren Zyrtare nr.85, datë 21 prill 2017, hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Pra për të qenë të saktë Ligji i faljes kishte hyrë në fuqi, pasi vendimi nr.854 datë 28.12.2016 i

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër kishte marrë formën e prerë më datë 22.02.2017. Pra nuk qëndronte dhe sa pretendonte pala paditëse, referuar përmbajtjes së kërkesë-padisë, se është tërhequr nga gjykimi i çështjes sapo ka dalë ligji i faljes.

Subjekti në lidhje me detyrimet në fjalë nuk është vlerësuar nga organi tatimor si përfitues, në zbatim dhe interpretim të dispozitave që parashikon ligji Nr.33/2017 “Për Pagesën dhe Fshirjen/Shuarjen e Detyrimeve Tatimore, Detyrimeve të Pagueshme në Doganë si dhe Procedurën e Heqjes nga Qarkullimi të Mjeteve të Transportit pas Fshirjes/Shuarjes së Detyrimeve Tatimore”.

Referuar këtij ligji në nenin 2 shprehet :

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime :

1. “Detyrime tatimore të papaguara” janë tatimi/kontributi/taksa/tarifa, kamatëvonesa dhe çdo dënim administrativ i lidhur ose jo me një lloj tatimi/takse/tarife/kontributi, sipas ligjit nr. 9920, datë 19.8.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ose ligjeve të tjera tatimore.

2. ....

3. “Subjekt” është individ, personi fizik, personi juridik.

Referuar po këtij ligji në nenin 3 shprehet :

**“Subjektet që përfitojnë”**

Nga përcaktimet e parashikuara në këtë ligj përfitojnë :

a) subjektet e regjistruara në regjistrin aktiv, pasiv ose të ç`regjistruar për detyrime tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore, sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11 të këtij ligji.

b) .....

Në nenin 5 shprehet :

**“Fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore”**

1. Fshihen/shuhet detyrimet tatimore të papaguara, sipas përcaktimit në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë dhe që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit, përveç kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2.Fshihen/shuhet detyrimet e papaguara, të përcaktuara sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, që u përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë.

3.Fshihen/shuhet dënimet administrative (gjobat) dhe kamatëvonesat për sigurimet shoqërore e shëndetësore që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë, që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit.

Në Udhëzimin nr.14 datë 03.05.2017 për zbatimin e këtij ligji pika IV **“Fshirja e detyrimeve tatimore”** shprehet :

1. Fshihen/shuhet automatikisht detyrimet tatimore të papaguara sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 2 të ligjit, që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë, dhe që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit, përveç kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Këtu përfshihet çdo detyrim tatimor i regjistruar në sistemin informatik ose jashtë sistemit, por që është i regjistruar në kontabilitetin e drejtorive rajonale tatimore.

1.1 Fshihen/shuhet detyrimet e akcizës të administruara nga ana e organit tatimor që i përkasin periudhave deri në 31 dhjetor 2010.

2. Fshihen/shuhet detyrimet e papaguara të përcaktuara sipas ligjit nr. 9632/2006 “Për taksat vendore” i ndryshuar, që u përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë sipas regjistrimeve të pushtetit vendor.

3. Fshihen/shuhen automatikisht dënimet administrative (gjobat) dhe kamatëvonesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë, që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit.

4. Për rastet kur data e njoftim vlerësimit apo akt konstatimit mban datën 31.12.2010 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse.

Në nenin 6 shprehet :

**“Fshirja/shuarja pjesore e detyrimeve tatimore me kusht pagimin e tatimit /taksës /tarifës /kontributit”**

1. Fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të regjistruara në llogarinë e subjektit, me kushtin që, brenda datës 31.12.2017, të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi për :

a) detyrimet tatimore, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 - dhjetor 2014, duke u aplikuar sipas llojit të tatimit;

b) kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 - dhjetor 2014;

c) taksat/tarifat vendore të papaguara, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 - dhjetor 2014.

2. Ky nen zbatohet edhe në rastin kur tatimi /taksa/tarifa/kontributi është paguar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në Udhëzimin nr.14 datë 03.05.2017 për zbatimin e këtij ligji pika V **“Fshirja/Shuarja pjesore e detyrimeve tatimore me kusht pagimin e tatimit/taksës/tarifës/kontributit”** shprehet :

1. Fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të regjistruara në llogarinë e subjektit, me kushtin që deri më 31.12.2017, të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi, për:

a) detyrimet tatimore, që i përkasin periudhave tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014, duke u aplikuar sipas llojit të tatimit;

b) kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që i përkasin periudhave tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014;

c) taksat/tarifat vendore të papaguara, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014;

2. Ky përcaktim zbatohet edhe në rastin kur tatimi/taksa/tarifa/kontributi është paguar përpara hyrjes në fuqi të ligjit. Nëse subjekti për një periudhë të caktuar nuk ka tatim për të paguar për periudhat tatimore sipas llojit të tatimit që i përkasin periudhave janar 2011 deri në dhjetor 2014, duke qenë se e ka paguar më parë ose tatimi ka qenë zero, atëherë atij i aplikohet fshirja/shuarja e kamatëvonesave dhe gjobave sipas përcaktimeve në nenin 6 të ligjit dhe kësaj pike të udhëzimit.

3. Për rastet kur data e njoftim vlerësimit apo akt konstatimi mban datën 31.12.2014 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse.

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të dërgojë zyrtarisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave detyrimet e tatimpaguesve për akcizë/gjobë/ kamatëvonesë e dënim administrativ për periudhën tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014 sipas periudhave që i përkasin.

Në nenin 7 shprehet :

**“Fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore të tjera”**

Janë, gjithashtu, objekt i fshirjes/shuarjes, sipas këtij ligji, detyrimet tatimore të mëposhtme, pavarësisht periudhës tatimore së cilës i përkasin :

a) detyrimet tatimore, përfshirë tatimin /kontributin/taksën/tarifën, kamatëvonesën dhe dënimet

administrative për subjektet persona fizikë ose juridikë që rezultojnë të ç`regjistruar në QKB me vendim gjykate apo që janë të çregjistruar në administratën tatimore deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) dënimet administrative (gjobat) tatimore të llogaritura automatikisht nga sistemi për deklarim të vonuar, sipas nenit 113, të ligjit nr. 9920, datë 19.8.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, deri më 31.12.2016, përfshirë edhe dënimet që lidhen me afatin e deklarimit të të punësuarve;

c) dënimet administrative (gjobat) për dorëzim të vonuar të vendimit për destinimin e rezultatit dhe dorëzim me vonesë të pasqyrave financiare të aplikuara, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të llogaritura deri në datën 31.12.2016;

ç) dënimet administrative (gjobat) për mosdeklarim në afat, për deklarata të padorëzuara, me kusht që çdo deklaratë e padorëzuar të dorëzohet deri në datën 30.6.2017;

d) dënimet administrative (gjobat) për shoqëritë e autorizuar, të parashikuara në nenin 123, të ligjit nr. 9920, datë 19.8.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të evidentuara në llogarinë e subjektit nëpërmjet aktkonstatimit, deri në datën 31.12.2016;

dh) dënimet administrative (gjobat) si rezultat i aplikimit të dispozitave të ligjit nr.99/2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.8.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese;

e) përveç sa parashikohet në nenin 5 të këtij ligji, fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara, sipas përcaktimit në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të detyrimeve të vetdeklaruara dhe të papaguara, të shoqërive që operojnë në sektorin elektroenergjetik dhe janë 100 për qind me kapital shtetëror, që i përkasin periudhave tatimore nga 1.1.2011 deri më 31.12.2013. Gjobat dhe kamatvonesat për kontributet e sigurimeve dhe detyrimet e vetdeklaruara për këto periudha, fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi. Për detyrimet e këtyre shoqërive për periudhën janar deri në dhjetor 2014, fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kushtin që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi;

ë) përveç sa parashikohet në nenin 5, të këtij ligji, fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara, sipas përcaktimit në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të shoqërive që operojnë në sektorin ujësjellëskanalizime dhe janë 100 për qind me kapital shtetëror, që u përkasin periudhave tatimore nga 1.1.2011 deri më 31.12.2013. Gjobat dhe kamatvonesat për kontributet e sigurimeve për këto periudha fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë kontributi. Për detyrimet e këtyre shoqërive për periudhën janar deri në dhjetor 2014, fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kushtin që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi;

f) fshihen/shuhen efektet tatimore për detyrime të papaguara, të regjistruara ose jo apo në proces kontrolli, si pasojë e lëshimit jo brenda së njëjtës periudhë tatimore të kryerjes së furnizimit, të dokumentit që vërteton përjashtimin nga TVSH-ja ose si pasojë e moslëshimit të këtij vërtetimi, me kusht që, në çdo rast, aplikimi pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore të jetë paraqitur deri më 31.12.2014;

g) fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të vetëpunësuarit në bujqësi, që i përkasin periudhave nga 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2016, me kusht pagesën e kontributeve brenda datës 31.12.2017.

**Në Udhëzimin nr.14 datë 03.05.2017 për zbatimin e këtij ligji pika VI “Fshirja/Shuarja e detyrimeve tatimore të tjera” shprehet :**

Janë gjithashtu objekt i fshirjes/shuarjes sipas ligjit, detyrimet tatimore të mëposhtme, pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin:

1. Fshihen/shuhen automatikisht detyrimet tatimore përfshirë tatimin/kontributin/taksën/ tarifën, kamatëvonesën dhe dënimet administrative për subjektet persona fizikë ose juridike, të cilët rezultojnë të ç`regjistruar në QKB, me vendim gjykate ose që janë të ç`regjistruar në administratën tatimore deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit.

2. Në zbatim të nenit 7 të ligjit, fshihen/ shuhen në mënyrë automatike dënimet administrative (gjobat) tatimore të llogaritura automatikisht nga sistemi për deklarim të vonuar sipas nenit 113 të ligjit nr.9920, datë 19.08.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, deri më 31.12.2016, përfshirë edhe dënimet që lidhen me afatin e deklarimit të të punësuarve pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin.

3. ....  
Në nenin 8 të ligjit në fjalë shprehet :

**“Kompensimi i detyrimeve debitoare me gjendjen kreditore dhe tepricën kreditore të TVSH-së”**

1. Subjektet që kanë tepricë kreditore të TVSH-së ose të një tatimi tjetër përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore, sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11, të këtij ligji, pas kompensimit (zvogëlimit) të tepricës deri në masën e tatimit të papaguar.

2. Në rastet kur teprica nuk mbulon vlerën e plotë të tatimit të papaguar, atëherë duhet të kryhet pagesa për pjesën e mbetur, sipas nenit 6, të këtij ligji, dhe më pas bëhet fshirja/shuarja e dënimeve administrative.

3. Përcaktimet e këtij neni për kompensimin zbatohen automatikisht, pa kontroll, përveç rasteve të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të këtij ligji, për të cilat ky nen zbatohet kur subjekti heq dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës kompetente.

4. Sipas këtij neni, kompensimit nuk i nënshtrohen detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

*Shoqëria “Hoti-D” sh.p.k në lidhje me detyrimin e saj nuk është vlerësuar nga organi tatimor si përfituese për faljen e këtyre detyrimeve pikërisht, sepse rasti i saj nuk bazohet apo identifikohet në rastet e parashikimeve sipas dispozitave të sipërcituara ligjore dhe nënligjore të faljes.*

Këto gjoba nuk ishin objekt i fushës së zbatimit të ligjit të faljes në fjalë.

Referimi që bënte subjekti paditës në përmbajtjen e kërkesë-padisë në nenin 6 të ligjit Nr.33/2017 ishte i gabuar, pasi nuk ishim përballë një rasti të tillë.

Në nenin 6 shprehet :

**“Fshirja/shuarja pjesore e detyrimeve tatimore me kusht pagimin e tatimit /taksës /tarifës /kontributit”**

1. Fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të regjistruara në llogarinë e subjektit, me kushtin që, brenda datës 31.12.2017, të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi për :

a) detyrimet tatimore, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 - dhjetor 2014, duke u aplikuar sipas llojit të tatimit;

b) kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 - dhjetor 2014;

c) taksat/tarifat vendore të papaguara, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 - dhjetor 2014.

2. Ky nen zbatohet edhe në rastin kur tatimi /taksa/tarifa/kontributi është paguar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pra bëhet fjalë për gjoba të vendosura apo të lidhura me një tatim të caktuar. Këto faleshin në qoftë

se më parë është paguar tatimi nga i cili ato rrjedhin.

Ndërsa gjobat për “mosdeklarim punonjësi”, “moslëshim të kuponit tatimor” ... etj janë dënime që vendosen për shkelje të një dispozite të vendosur në ligj, por që nuk lidhen me një tatim të caktuar. Ndryshe quhen “gjoba pa tatim”.

Këto gjoba nuk ishin objekt i fushës së zbatimit të ligjit të faljes në fjalë.

Në zbatim të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, detyrimi tatimor, por dhe detyrimi lidhur me kontributet ka tre komponentë :

- detyrimin si principal
- kamatëvonesën
- gjobën

Me aktin nr.\_\_\_\_ Prot., datë 24.05.2018 nga D.R.T Shkodër subjektit i është kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën e tij protokolluar në këtë Drejtori me nr. \_\_\_\_ Prot., datë 08.05.2018.

➤ **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër** me vendimin nr.\_\_\_\_, datë 27.09.2018 ka vendosur:

- *Kthimin e kërkesë-padisë, paditësit Shoqëria “Hoti-D” sh.p.k për shkak të mosplotësimit të të metave të saj.*

Gjykata konstatoi një të metë të padisë, në lidhje me mosparaqitjen e Ekstraktit të QKR - së së palës paditëse Shoqëria “H” sh.p.k. Në seancë gjykata i la detyrë përfaqësuesit për të sjellë ekstraktin deri në seancën e ardhshme gjyqësore.

Në seancën gjyqësore të caktuar nga Gjykata, nuk u paraqit përfaqësuesi i palës paditëse, pavarësisht dijenisë që ai kishte për datën dhe orën e seancës gjyqësore.

Në këto rrethana gjykata vendosi kthimin e padisë dhe akteve që i janë bashkëlidhur asaj, paditësit Shoqëria “H” sh.p.k.

➤ Mbi bazën e ankimit të palës paditëse çështja është shqyrtuar nga **Gjykata Administrative e Apelit, e cila me vendimin e saj nr.\_\_\_\_, datë 18.06.2025** vendosi:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.\_\_\_\_, datë 27.09.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*

- *Kundër këtij vendimi lejohet rekurs brenda 30 ditëve në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke filluar afati nga e nesërmja e marrjes dijeni të vendimit të arsyetuar me shkrim*

Sipas vendimmarrjes së kësaj gjykate nga shqyrtimi i akteve procedurale që përmban dosja gjyqësore nuk konstatohet ndonjë akt apo veprim, që përfshihet në rastet e parashikuara në nenin 467 të Kodit të Procedurës Civile apo raste të tjera të parashikuara në ligj dhe që ngrihen kryesisht në lidhje me parakushtet formale të padisë apo me zbatimin e ligjit procedural, të tilla që mund të vlerësohen se sjellin cënimin e procesit të rregullt ligjor.

Gjykata në rastin konkret nuk ka bërë asnjë shkelje të procedurës. Ka vërejtur të metën në seancë, ka vendosur me vendim të ndërmjetëm një afat të arsyeshëm dhe kur pala nuk e përmbushi vendosi kthimin e kërkesë-padisë. Sipas Gjykatës Administrative të Apelit tashmë kjo është një praktikë e zakonshme dhe e konsoliduar gjyqësore.

Është detyrim i palës paditëse t'i sigurojë gjykatës mundësinë e verifikimit të elementëve formal sikurse është rregjistrimi në QKB. Pavarësisht mundësisë që gjykata ka të verifikojë këtë fakt në "Eeb-site"-in elektronik zyrtar, detyrimi i palës paditëse që investon gjykatën për shqyrtimin e padisë është primar. Gjykata ndërhyr dhe lehtëson vijimësinë e procesit, nëse pala ka pengesë në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm, por jo kur pala refuzon përmbushjen e detyrimeve të ngarkuara nga gjykata në përputhje me ligjin.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se, vendimi nr.\_\_\_\_, datë 27.09.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe për rrjedhojë duhet të lihet në fuqi.

### **Vendimi i Gjykatës:**

**Gjykata Administrative e Apelit, e cila me vendimin e saj nr.\_\_\_\_, datë 18.06.2025, vendosi:**

- *Lënie në fuqi të vendimit nr.\_\_\_\_, datë 27.09.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër*
- *Kundër këtij vendimi lejohet rekurs brenda 30 ditëve në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke filluar afati nga e nesërmja e marrjes dijeni të vendimit të arsyetuar me shkrim.*

### **19. Vendim nr.\_\_\_\_, datë 15.10.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës :** H. T, NIPT: L\_\_\_\_\_

**Të paditur :** Drejtoria e Apelit Tatimor, pranë Ministrise se Financave  
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë  
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër  
Drejtoria e Hetimit Tatimor, Rajoni Verior Shkodër

**Objekti :** "1.Konstatimin e pavlefshmërisë absolute ose shfuqizimin e akteve administrative, përkatësisht njoftim vleresimi nr.\_\_\_\_ Prot., datë 13.04.2017 për detyrimet e t.v.sh-së dhe tatim fitimit si dhe të gjobave përkatëse ardhur me shkresën nr.\_\_\_\_ Prot., datë 04.05.2017 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.

2.Konstatimin e pavlefshmërisë absolute ose shfuqizimin e aktit administrativ vendimit nr.\_\_\_\_, datë 21.07.2017 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Ministrise së Financave.

### 3. Detyrimin e palëve të paditura të paguajnë shpenzimet gjyqësore”

**Shuma e detyrimit tatimor:** \_\_\_\_\_ lekë

#### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Subjekti H.T është subjekt tregtar në administrim të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, me NIPT: L\_\_\_\_\_, me objekt aktiviteti “bar kafe, kreperi...”. Subjekti është i regjistruar pranë organit tatimor përse i perket pergjegjësive tatimore si subjekt i tatimit mbi fitimin, i tatimit mbi vlerën e shtuar, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore .....

- Drejtorja Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin me detyrime sipas njoftim-vlerësimit me numër nr.\_\_\_\_ Prot., datë 13.04.2017, në të cilin janë pasqyruar në mënyrë të detajuar këto detyrime sipas zërit përkatës tatimor dhe periudhave përkatëse tatimore.
- Drejtorja Rajonale e Tatimeve Shkodër në ndjekje të mëtejshme të praktikës së mbajtur nga Drejtorja e Hetimit Tatimor, Rajoni Verior, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, Akt konstatimi me numër serie \_\_\_\_\_, datë 10.03.2017, numër serie \_\_\_\_\_ datë 10.03.2017, numër serie \_\_\_\_\_ datë 10.03.2017, numër serie \_\_\_\_\_ datë 10.03.2017 përfundimisht ka nxjerrë aktin administrativ, njoftim vlerësimin tatimor nr.\_\_\_\_ prot datë 13.04.2017, i cili në vijim të procedurave i është njoftuar subjektit H.T nga Drejtorja Rajonale e Tatimeve Shkodër.

Në zbatim të ligjit, bazuar në konstatimin e bërë sipas akt konstatimeve të sipërcituara nga grupi i punës së Drejtorisë së Hetimit Tatimor është mbajtur dhe Proces-verbali i gjobës me numër serie \_\_\_\_\_ datë 10.03.2017 sipas të cilit subjekti është sanksionuar me gjobë në vlerën \_\_\_\_\_ lekë për “moslëshim të kuponit tatimor për herë të dyte”, bazuar në ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 122 pika 1 germa b/i.

Nga organi tatimor ndaj këtij tatimpaguesi dhe më parë ishte marrë masa administrative e gjobës, bazuar në praktikën e mbajtur nga grupi i punës së hetimit tatimor sipas Akt konstatimit me numër serie \_\_\_\_\_ datë 27.12.2016, mbajtur dhe Proçesverbali i gjobës me numër serie \_\_\_\_\_ datë 27.12.2016 sipas të cilit subjekti është sanksionuar me gjobë në vlerën \_\_\_\_\_ lekë për “moslëshim të kuponit tatimor”, bazuar në ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 122, pika 1 germa b/i. Mbi bazën e kësaj praktike është nxjerrë dhe njoftim vlerësimi nga sistemi informatik tatimor me nr. \_\_\_\_\_, datë 28.12.2016, komunikuar subjektit me aktin nr.\_\_\_\_ prot datë 06.01.2017.

Në zbatim të ligjit nga grupi i punës së hetimit tatimor është mbajtur dhe Proces-Verbal Sekuestrimi datë 10.03.2017, sipas të cilit subjektit iu bë sekuestrimi i pajisjeve kompjuterike si dhe vendosja e fashetave te posaçme sipas përshkrimit në rubrikën “emërtimi” në këtë akt.

Në mbështetje dhe në ndjekje të kësaj praktike të Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Verior komunikuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, pranë saj në zbatim të nenit 127, pika 3 të ligjit

nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikes 127.3 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në mbështetje të Udhëzimit nr. 19723 prot date 17.07.2014 të D.P.T-ve, Urdhrit nr. \_\_\_\_ prot datë 13.03.2017 të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore u bë ngritja e grupit të punës për vlerësimin e të dhënave në pajisjet kompjuterike të sekuestruara.

Në bazë të urdhrit të punës nr. \_\_\_\_ prot datë 13.03.2017 nga grupi i punës së vlerësimit u bë verifikimi i pajisjes kompjuterike jo fiskale marrë në dorezim me Proçesverbal dorëzimi me numër serie \_\_\_\_\_ datë 13.03.2017 nga grupi i punës së sekuestrimit të bërë.

Në përfundim të punës nga grupi i vlerësimit u hartua Raporti i grupit të punës mbi verifikimin e pajisjeve kompjuterike jofiskale dhe pasqyruar në aktin nr. \_\_\_\_ prot datë 17.03.2017.

Grupi i punës ka bërë të mundur aksesin në database-in e programit dhe nxjerrjen e të dhënave për shitjet totale (nga data 12.06.2016 - 10.03.2017). Relacioni është komunikuar pranë Drejtorisë së Kontrollit (Sektorit të kontrollit nga zyra) për zbatim. Ka rezultuar se për vitin 2016 subjekti ka realizuar xhiro vlerë të tatueshme \_\_\_\_ lekë dhe TVSH përkatëse \_\_\_\_ lekë në vlerë totale \_\_\_\_ lekë. Për periudhën 01.01.2017 deri 10.03.2017 subjekti ka realizuar xhiro vlerë të tatueshme \_\_\_\_ lekë dhe TVSH përkatëse \_\_\_\_ leke, në vlerë totale \_\_\_\_ lekë.

Në zbatim të ligjit nr.9920, dt.19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71,72 si dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave në zbatim të tij, janë rritur shitjet e tatueshme të periudhës tatimore 2016/12 për \_\_\_\_ lekë dhe rezultati është detyrim TVSH-je në periudhën tatimore 2016/12 për \_\_\_\_ lekë si dhe janë rritur shitjet e tatueshme të periudhës tatimore 2017/02 për \_\_\_\_ lekë dhe rezultati është detyrim TVSH-je në periudhën tatimore 2017/02 për \_\_\_\_ lekë.

Bazuar në ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 116 “Evazionit tatimor”, subjekti detyrohet të paguaje një Gjobë në masën 100% të detyrimit të mësipërm, Gjobë për TVSH -2016/12 në shumën \_\_\_\_ lekë dhe Gjobë për TVSH 2017/02 në shumën \_\_\_\_ lekë.

Në vijim Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin me detyrime sipas njoftim-vlerësimit me numër nr. \_\_\_\_ prot datë 13.04.2017, në të cilin janë pasqyruar në mënyrë të detajuar këto detyrime sipas zërit përkatës tatimor dhe periudhave përkatëse tatimore.

- Subjekti duke mos qenë dakord me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Ministrisë së Financave me një kërkesë ankimore. Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj, komunikuar me shkresën nr. \_\_\_\_ prot datë 21.07.2017 subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit vendos:

- *Refuzimin e ankimit ndaj njoftim vlerësimit nr. \_\_\_\_ prot datë 13.04.2017, nxjerrë nga D.R.T Shkodër për shkak se tatimpaguesi nuk ka përmbushur kushtet paraprake për marrjen në shqyrtim të ankimit.*

## Vlerësimi i Gjykatës:

➤ **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër lidhur me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.\_\_\_\_, datë 09.04.2019 sipas të cilit vendosi:**

- *Rrëzimin e kërkesë padisë si të pa bazuar në prova e në ligj .....*

Kjo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se:

Pala paditëse me anë të padisë, pretendon për pavlefshmëri absolute të aktit administrativ të palës së paditur.

Para trajtimit me radhë të pretendimeve të palës paditëse në lidhje me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, gjykata ndalet në disa konsiderata të rëndësishme.

Së pari, pavlefshmëria absolute e aktit administrativ mund të kërkohe në çdo kohë në referim të nenit 18 pika 8 e Ligjit 49/2012.

Së dyti, gjykata ka juridiksion gjyqësor për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshje. Në nenin 16 të Ligjit nr.49/2012 parashikohet nevoja e ezaurimit të rrugës administrative para se një subjekt i caktuar t'i drejtohet me padi gjykatës. Por, ka edhe përjashtime. Po kështu, kur me padinë kërkohe pavlefshmëria absolute e aktit administrativ, nuk është e nevojshme ezaurimi i rrugës administrative apo detyrimi për zbatimin e ndonjë afati ligjor për t'iu drejtuar gjykatës.

Në lidhje me themelin e pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse, në nenin 108 të K.Pr.Administrative përcaktohen rastet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ: *a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.*

Në lidhje me kompetencën e organit publik, detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore janë të përcaktuara qartë në nenin 105 të Ligjit nr.9920/2008 i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, VKM nr. 400, datë 22.4.2009 "Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor" dhe në "Manualin e Veprimtarisë së Hetimit Tatimor", Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore.

Në lidhje me procedurën e nxjerrjes së akteve objekt padie: Akti administrativ - njoftim vlerësimi për detyrimet nr.\_\_\_\_, datë 13.4.2017 të DRT-ve Shkodër është nxjerrë në bazë të kontrollit të ushtruar nga inspektorët e Drejtorisë së Hetimit Rajonal Verior më datë 10.3.2017. Ky kontroll

është formalizuar në aktet e konstatimit të sipërcituara. Nga kontrolli i ushtruar kanë rezultuar shkelje administrative të cilat janë të ndërshkueshme administrativisht në bazë të ligjit nr.9920/2008. Meqenëse shkelja e konstatuar ishte e përsëritur (për herë të dytë), me të drejtë është vijuar me bllokimin e ushtrimit të aktivitetit tregtar për një periudhë ligjore 30 ditore. Gjithashtu në bazë të nenit 127, të Ligjit nr.9920/2008 është vendosur edhe sekuestrimi i pajisjes kompjuterike. Në bazë të urdhrit nr.\_\_\_\_, datë 13.3.2017 është ngritur grupi i punës i cili ka bërë vlerësimin e pajisjes kompjuterike jo fiskale. Në vlerësim të gjykatës, procedura e ndjekur nga inspektorët e palës së paditur është e bazuar në ligj.

Në lidhje me formën dhe elementët e detyrueshëm të aktit, jo vetëm akti final, por edhe aktet e tjera janë përpiluar në formë shkresore dhe nuk përbëjnë shkak për pavlefshmëri absolute të tyre.

Në lidhje me rastin kur akti është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale, nuk rezultoi gjatë shqyrtimit gjyqësor se aktet administrative objekt padie të jenë nxjerrë në ndonjërin prej rasteve të sipërcituara. Në lidhje me rastin kur ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal, njoftim vlerësimi për detyrimet i nxjerrë nga pala e paditur DRT Shkodër është në fuqi, pra nuk është cenuar nga pala e paditur DAT. Në vlerësim të gjykatës ekzekutimi i këtij akti, nuk passjell përgjegjësi penale sipas Kodit Penal.

Duke konkluduar, gjykata ka arritur në përfundimin se aktet objekt padie nuk janë absolutisht të pavlefshme, në kuptim dhe zbatim të nenit 108 të K.Pr.Administrative. Prandaj kërkesëpadia, duhet të rrëzohet si e pa bazuar në prova e në ligj.

- Mbi bazën e kërkesës ankimore të palës paditëse çështja u shqyrtua nga **Gjykata Administrative e Apelit**, e cila ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në ankimin e palës paditëse H.T, Person Fizik, nuk janë të mbështetura në prova dhe në ligj.

Për rrjedhojë, vendimi nr. \_\_\_\_\_, datë 09.04.2019, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duhet të mbetet në fuqi.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se gjykata administrative e shkallës së parë ka parashtruar konkretisht rrethanat e faktit që ka pranuar të vërtetuara nga vlerësimi dhe çmimi i provave, si edhe ka identifikuar, interpretuar dhe zbatuar ligjin e zbatueshëm në lidhje me këto fakte, pikërisht në raport me kërkimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse për ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar të evidentojë se, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural të zbatueshëm, mjeti i kundërshtimit të vendimit gjyqësor, përfshirë apelin, është mjet procedural me të cilin pala e legjitimuar në gjykim dhe ankim parashtron shkaqe konkrete të lidhura me faktin apo ligjin e zbatueshëm se përse pretendon që gjykata, në vendimin gjyqësor të dhënë, nuk ka zbatuar drejt ligjin apo nuk ka vlerësuar drejt provat dhe rrethanat e çështjes (neni

442/a, 454, 465 i K.Pr.Civile). Nëpërmjet ankimit nuk i kërkohet gjykatës së shkallës së dytë të zhvillojë një gjykim të ri duke injoruar gjykimin e zhvilluar në shkallë të parë, por i kërkohet që të shqyrtojë drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe ligj të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Prandaj, paraqitja e një ankimi ku, në vend që të paraqiten shkaqe konkrete se në cilat pjesë të arsyetimit dhe disponimit pretendohet se vendimi i kundërshtuar është i pabazuar në prova dhe/ose ligj, por thjesht ripërsëriten motivet mbi faktin dhe ligjin të ngritura në padi dhe në parashtrimet përpara gjykatës administrative të shkallës së parë, përbën një ankim që është në kufijtë e pranueshmërisë për shqyrtim sepse praktikisht është një ankim që nuk përmban shkaqe konkrete ankimi sikurse kërkon ligji, por thjesht një kundërshtim gjenerik, pa shkaqe konkrete, për arsyetimin dhe disponimin e gjykatës për zgjidhjen e çështjes.

Në mungesë të çështjeve mbi ligjin procedural të zbatueshëm dhe që ngrihen edhe kryesisht nga gjykata, si edhe në mungesë të shkaqeve thelbësore konkrete të ankimit të paraqitur nga pala paditëse, pra të motiveve konkrete se në cilat pjesë të vendimit gjyqësor të ankimit gjykata nuk ka zbatuar, apo ka zbatuar gabim ligjin procedural, ose material dhe se cilat prova, apo fakte nuk ia kanë shtruar debatit gjyqësor, ose nuk i ka vlerësuar në vendim, në respektim të parimit themeltar të gjykimin se gjykata shprehet për gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet (neni 6 i K.Pr.Civile), duke iu përmbajtur në vendimin e saj kufijve të shqyrtimit në apel (neni 465 pika 1 i K.Pr.Civile), Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se duhet të disponojë lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Gjithsesi, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se arsyetimi i gjykatës administrative të shkallës së parë është i drejtë, i plotë dhe i mbështetur si në ligj, ashtu edhe në faktet e provuara gjatë gjykimin. Ajo gjykatë ka analizuar saktë kushtet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, sipas nenit 108 të K.Pr.Administrative, duke verifikuar një nga një kriteret ligjore që lidhen me kompetencën e organit, procedurën e nxjerrjes së aktit, formën dhe elementët e tij thelbësorë, si dhe mungesën e rrethanave që lidhen me mashtrimin, veprime penale apo pasoja penale nga ekzekutimi i aktit. Nga shqyrtimi i akteve administrative dhe kuadrit normativ përkatës, është arritur në përfundimin se palët e paditura kanë vepruar brenda kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 9920/2008 dhe aktet nënligjore përkatëse, ndërsa procedura e kontrollit, konstatimit të shkeljeve, vendosjes së masave administrative dhe nxjerrjes së njoftim-vlerësimit është ndjekur në përputhje me ligjin.

Po ashtu, Gjykata Administrative e Shkallës së parë ka arsyetuar drejt dhe hollësisht duke çmuar se aktet administrative objekt padie janë të rregullta edhe nga pikëpamja formale, janë përpiluar në formë shkresore dhe nuk rezulton asnjë element që të cenojë vlefshmërinë e tyre absolute.

Në vlerësim të pretendimit të paditësit se nuk ka marrë njoftim për vendimin përfundimtar dhe, për rrjedhojë, akti administrativ duhet të konsiderohet i pavlefshëm relativisht, Kolegji çmon se edhe ky shkak ankimi nuk qëndron. Nga shqyrtimi i rrethanave faktike dhe dokumentacionit administrativ rezulton se procedura tatimore është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme dhe të

dokumentuar, me pjesëmarrjen faktike të subjektit gjatë kontrollit tatimor, sekuestrimit të pajisjeve, mbajtjes së akteve të konstatimit dhe vendosjes së masave administrative, për të cilat paditësi ka pasur dijeni reale dhe efektive. Vetë fakti që paditësi ka ushtruar ankim administrativ ndaj njoftim-vlerësimit për detyrimet tatimore pranë palës së paditur DAT dëshmon se ai ka qenë i njohur me ekzistencën, përmbajtjen dhe pasojat juridike të aktit administrativ përfundimtar.

Për më tepër, edhe në rast se do të pranohej hipotetakisht një mangësi formale në njoftim, kjo rrethanë, në kushtet konkrete, nuk ka sjellë cenim të së drejtës së mbrojtjes së paditësit dhe as nuk ka ndikuar në përmbajtjen ose ligjshmërinë e aktit administrativ, për sa kohë paditësi ka pasur mundësi reale për të kundërshtuar aktin, si në rrugë administrative, ashtu edhe në gjykatë.

Në këto kushte, nuk plotësohen as elementet e pavlefshmërisë relative të aktit administrativ, pasi nuk provohet se shkelja e pretenduar procedurale ka prodhuar pasoja konkrete mbi të drejtat ose interesat e ligjshme të paditësit, në kuptim të K.Pr.Administrative.

Bazuar në arsyetimin dhe përfundimet e parashtruara më sipër në këtë vendim, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se, ankimi i palës paditëse H.T, nuk është i mbështetur në prova dhe në ligj. Për rrjedhojë, vendimi nr. \_\_\_\_\_, datë 09.04.2019, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duhet të mbetet në fuqi.

### **Vendimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë 15.10.2025 vendosi:

- 1. Lënien në fuqi të vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë 09.04.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*
- 2. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.*